



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 23

4 mars

2013

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i GJK nr. 2, datë 18.2.2013	Me objekt: 1. Shfuqizimi si antikushtetues i ligjit nr. 10367, datë 23.12.2010 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 5, datë 10.11.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”; 2. Shfuqizimi si antikushtetues i kreut II, fjala “neto” gjerat “c” dhe “e”; kreu V pika 2 fjala “neto” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 793, datë 24.9.2010 “Për zbatimin e ligjit nr. 10 142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë””, të ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 9.2.2011.....	893
Vendim i GJK nr. 3, datë 19.2.2013	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 1100, datë 30.9.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr. 00-2011-01, datë 13.1.2012 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	900
Vendim i GJK nr. 4, datë 20.2.2013	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.....	909

Vendim i GJK nr. 5, datë 25.2.2013	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimeve nr. 127, datë 26.11.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë; nr. 87, datë 28.3.2002 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 590, datë 25.10.2002 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).....	913
Vendim i GJK nr. 6, datë 26.2.2013	Me objekt: - Shfuqizimi, si të papajtueshme me Kushtetutën, të vendimeve: nr.1, datë 12.1.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr.62, datë 29.2.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; -Pezullimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.....	919
Vendim i GJK nr. 7, datë 27.2.2013	Me objekt: -Kontrolli i kushtetutshmërisë së nenit 11/2 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar; -Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë nr. 991/3, datë 2.3.2010 “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 13, datë 12.2.2009 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë, Noterisë dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”; -Interpretimi përfundimtar i nenit 155 të Kushtetutës, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, mbi bazën e parimit të aftësisë paguese.....	927

VENDIM
Nr. 2, datë 18.2.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Admir Thanza	anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datë 29.5.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 16/2 Akti që i përket:

KËRKUES: Shoqata e Xheniereve të Shqipërisë, përfaqësuar nga Kadri Muka, me deklaram.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Arjeta Cefa me autorizim.

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.

Ministria e Financave, përfaqësuar nga Gentian Opre, me autorizim.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, përfaqësuar nga Ali Emini dhe Merita Selita, me autorizim.

OBJEKTI: 1. Shfuqizimi si antikushtetues i ligjit nr. 10367, datë 23.12.2010 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 5, datë 10.11.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 142, datë 15.5.2009” “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”;

2. Shfuqizimi si antikushtetues i kreu II, fjala “neto” germat “c” dhe “e”; kreu V pika 2 fjala “neto” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 793, datë 24.9.2010 “Për zbatimin e ligjit nr. 10 142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 9.2.2011.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nenet 1/1, 3, 4 pika 1 e 2, 15/1, 18/2, 124/1, 131, shkronja “a” dhe 134/1, shkronja “f”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Xhezair Zaganjori, përfaqësuesin e palës kërkuese që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (Kuvendi), në datën 15.5.2009, miratoi ligjin nr. 10 142, i cili bënte disa ndryshime në masën dhe mënyrën e përlllogaritjes së pensionit suplementar të ushtarakëve të liruar. Këto ndryshime u kundërshtuan nga Shoqata e Ushtarakëve të Shqipërisë para Gjykatës Kushtetuese.

2. Gjykata Kushtetuese (Gjykata), me vendimin nr. 33, datë 24.6.2010, shfuqizoi si antikushtetues nenin 14/2 dhe nenin 27 të këtij ligji.

3. Pas hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës, u miratua vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 793, datë 24.9.2010 “Për zbatimin e ligjit nr. 10 142, datë 15.5.2009 Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve...”, me anë të të cilit u parashikua se “*deri në reflektimin ligjor të vendimit nr. 33, datë 24.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese, përfitimet dhe efektet financiare që rrjedhin prej tyre llogariten dhe zbatohen sipas ligjit nr. 10 142, datë 15.5.2009 pa ndryshime*”.

4. Më pas, Këshilli i Ministrave miratoi aktin normativ me fuqinë e ligjit nr. 5, datë 10.11.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 142, datë 15.5.2009 Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve”.

5. Kuvendi, në datë 23.12.2010, miratoi ligjin nr. 10 367, datë 23.12.2010 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 5, datë 10.11.2010...”.

6. Në zbatim të këtij akti, u miratua vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 9.2.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 793, datë 24.9.2010 “Për zbatimin e ligjit nr. 10 142, datë 15.5.2009 Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve...””, me anë të të cilit u vendos si pagë referuese mujore me qëllim llogaritjen e pensionit suplementar paga mujore *neto*. Sipas kërkesit, referimi te paga *neto* sjell ulje të masës së pensionit. Për këtë arsye, kërkesi iu drejtua me kërkesë Gjykatës, e cila me vendimin nr. 31, datë 5.3.2012 të Kolegjit, vendosi t’ia kthejë kërkesën për plotësim duke i kërkuar paraqitjen e përlllogaritjes në shifra konkrete të masës së pensionit sipas akteve të reja, me qëllim vërtetimin e pretendimit të kërkesit se aktet e reja kanë sjellë cenim të një të drejte të fituar më parë.

7. Në datën 26.3.2012, kërkesi e paraqiti përsëri kërkesën të shoqëruar me përlllogaritjet konkrete.

8. *Kërkesi* pretendon se aktet objekt kërkesë janë antikushtetuese dhe duhet të shfuqizohen, pasi:

8.1 Nuk është zbatuar në thelb vendimi i Gjykatës nr. 33/2010. Aktet kanë dalë disa muaj me vonesë nga hyrja në fuqi e vendimit të Gjykatës. Gjithashtu, aktet që kundërshtohen, kanë ndryshuar pjesë të dispozitave ligjore që nuk janë gjetur antikushtetuese nga kjo Gjykatë, prandaj ato nuk duhej të ishin prekur nga ligjvënësi. Aktet objekt kërkesë nuk garantuan qëndrueshmërinë dhe vijimësinë që synonte vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

8.2 Është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi aktet që kundërshtohen, parashikojnë një masë pensioni më të ulët se më parë. Shkak për këtë është vendosja e termit pagë referuese mujore *neto*, e cila jep si rezultat një masë pensioni më të ulët se ajo që përfitonin më parë. Këto rregullime bien ndesh edhe me praktikën e Gjykatës Kushtetuese. Sipas akteve objekt kërkesë, masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi nga 50% e pagës mesatare referuese bruto për 15 vite vjetërsi, u ul në masën 22.5% të pagës mesatare referuese neto për vit shërbimi.

9. *Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Kuvendi*, duke kërkuar rrëzimin e kërkesës, parashitroi këto prapësime:

9.1 Kërkesi nuk legjitimohet t’i drejtohet kësaj Gjykate, pasi ai nuk mund të kërkojë shfuqizimin e një akti normativ, i cili nuk ka për objekt vetëm rregullimin e skemës së pensioneve për anëtarët e shoqatës që ai përfaqëson, por edhe të subjekteve të tjera, të cilat përmbushin kushtet për të përfituar pensionin, sipas akteve që kundërshtohen para kësaj Gjykate.

9.2 Ndërhyrja për përllogaritjen e pensionit suplementar është bërë me qëllim normalizimin e situatës së pensioneve, pasi, pas hyrjes në fuqi të vendimit nr. 33/2010 të Gjykatës, skema e pensioneve për kategoritë përkatëse të ligjit pësoi një diskordancë të madhe dhe shkaktoi anomali për të gjithë skemën e përfitimeve në përgjithësi. Kjo ndodhi si shkak i heqjes së tavanit të përfitimeve suplementare duke i hapur rrugën krijimit të diferencave të mëdha dhe jo të arsyeshme midis masës së pensionit të parakohshëm dhe pagës mesatare neto nga puna. Shifra që duhet të mbulohet nga shteti bëhet e papërbalueshme dhe rrezikon seriozisht realizimin e së drejtës së të gjithë përfituesve të tjerë nga kjo skemë. Akti objekt kërkesë parashikon që përfitimi nga pensioni të përllogaritet si pjesë e përfitimit faktik mujor nga puna dhe nuk mund të jetë më i madh se paga neto që një ushtarak merr gjatë kohës që është në marrëdhënie pune.

9.3 Masa e pensionit e përllogaritur sipas formulës së re mbështetet në mundësinë reale buxhetore, ajo siguron respektimin e parimeve të funksionimit të skemave suplementare, si dhe ruajtjen e raporteve më të arsyeshme midis pensionit suplementar të ushtarakëve, atij të pleqërisë dhe pagës neto nga puna.

10. *Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave*, kërkoj rrëzimin e kërkesës me këto argumente:

10.1 Kërkuesi nuk legjitimohet në kërkimet e tij, pasi nuk arrin të provojë interesin dhe dëmin real që i vjen nga zbatimi i akteve që kundërshton. Ai nuk jep argumente bindëse që të vërtetojnë pasojat negative që vijnë nga referimi te paga neto e pensionit suplementar. Gjithashtu, kërkuesi nuk përfaqëson të gjithë kategoritë e ushtarakëve që përfshihen në rregullimet e akteve konkrete.

10.2 Nuk cenohet parimi i sigurisë juridike, pasi ndryshimet në ligj janë bërë të diktuar nga interesi publik. E drejta për pension nuk është e drejtë kushtetuese, por objektiv social dhe si i tillë nuk mund të kërkohet gjyqësisht.

10.3 Nuk cenohet parimi i barazisë para ligjit, pasi ligji rregullon ndryshe kategori të ndryshme subjektsh, sipas viteve të punës dhe kontributit të tyre.

11. *Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Ministra e Financave*, duke kërkuar rrëzimin e kërkesës, parashtrij këto prapësime:

11.1 Ligji i kundërshtuar nuk cenon parimet kushtetuese. Ai ka për qëllim të rregullojë balancat e përcaktuara për mbrojtjen sociale nga sigurimi shoqëror në Shqipëri dhe t'i përshtatë këto përfitime me mundësitë financiare për përbalimin e tyre nga buxheti i shtetit. Duke qenë se përfitimi për kategori të caktuara krijonte shpenzime të konsiderueshme dhe të papërbalueshme për buxhetin e shtetit, skema duhej të rishikohej.

11.2 Në bazë të përllogaritjeve të kryera në zbatim të dispozitave të nenit 14 të ndryshuar, koordinuar me rregullat e përcaktuara në nenin 29 të ligjit, efektet financiare vjetore shtesë mbi ato të llogaritura sipas dispozitave fillestare të ligjit, për përfituesit aktualë dhe ata që presin llogaritjen e përfitimeve përllogariten në 1.164 milionë lekë. Këto efekte financiare shtesë i përfitojnë rreth 7400 persona nga 11.312 persona që trajtohen me pensione të parakohshme për vjetërsi shërbimi. Përfitimi mujor për personat që kanë dalë në reformë nga viti 2004 e në vazhdim, përllogaritet nga 41.000 lekë e lart, ndërkohë mbi këto të ardhura nuk aplikohet tatimi mbi të ardhurat personale dhe ndërkohë që pensioni maksimal i pleqërisë për 35 vite shërbim është i kufizuar me dyfishin e pensionit bazë ose 21.380 lekë në muaj. Veç kësaj, për këta persona nga buxheti i shtetit paguhet edhe kontributi i sigurimit shoqëror të detyrueshëm, ndërkohë që të gjithë të punësuarit kontributin prej 11.2% të pagës e përballojnë nga të ardhurat e tyre mujore.

11.3 Parashikimi i përllogaritjes së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi bëhet mbi pagën mesatare referuese neto të momentit kur një përfitues përfiton pension. Në këtë mënyrë, përfitimi nga pensioni përllogaritet si pjesë e përfitimit faktik mujor nga puna dhe teorikisht nuk mund të jetë më i madh se paga neto që një ushtarak apo punonjës policie merrte gjatë kohës që ishte në punë. Ligji gjithashtu, harmonizon përfitimet dhe i bën të krahasueshme me ato që përfitohen nga



skemat e tjera, ndërkohë vendos të drejtën e zgjedhjeve më të favorshme në rastet kur mundësitë e përfitimeve janë nga disa skema suplementare të financuara nga shteti.

12. *Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Instituti i Sigurimeve Shoqërore*, u shpreh kundër pranimit të kërkesës duke parashtruar se ligji i ri merr përsipër të sigurojë një raport të drejtë mes kontributit dhe përfitimit duke iu përgjigjur edhe vjetërsisë në punë. Skema e mëparshme shkaktonte probleme të pariparueshme për buxhetin e shtetit për shkak të masës së madhe të përfitimit që rezultonte nga përllogaritjet. Kështu p.sh. një ushtarak me gradë major me 30 vite pune nëse do të trajtohej me ligjin e pandryshuar, do të merrte një pension që do të ishte afërsisht 2210 lekë, kurse me ligjin e ndryshuar do të ishte 3391 lekë. Në rastet kur një ushtarak ka pasur vetëm 15 vite punë, pagesa do të jetë më e ulët pra në proporcion me vitet e kontributit, gjë që mundësohet tashmë me skemën e re të pensionit suplementar. Qëllimi i ligjvënësit është që të rrisë pensionet suplementare për ata ushtarakë që kanë mbushur moshën 65 vjeç, pra janë në prag të pensionit dhe jo për të gjithë ushtarakët megjithëse mund të kenë më pak vite punë.

II

1. Mbi legjitimitimin e kërkuarit

13. Subjekti i interesuar, Kuvendi, pretendon se kërkuari nuk legjitimohet në kërkimet e tij, pasi nuk arrin të justifikojë interesin e drejtpërdrejt në çështjen konkrete. Gjykata në lidhje me këtë pretendim vëren se, bazuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë veprimtarinë e saj, legjitimiteti i kërkuarit përbën një nga parakushtet procedurale për ta vënë atë në lëvizje. Bazuar në aktet e krijimit të kërkuarit, Gjykata çmon se kërkuari përfshihet në rrethin e subjekteve “*organizata të tjera*” të parashikuara në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, të cilat kanë legjitimitet për t’iu drejtuar asaj.

14. Referuar nenit 134/2 të Kushtetutës, shoqatat dhe organizata të tjera janë subjekte që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për të iniciuar gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Në këtë kuptim, ato duhet të provojnë lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin janë krijuar apo veprimtarisë që ato kryejnë dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat, që kërkojnë të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 31/2010; nr. 4/2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Kërkuari është regjistruar si subjekt juridik me vendimin nr. 2434, datë 4.12.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt veprimtarie, midis të tjerave “*mbrojtjen e interesave të ushtarakëve xhenierë dhe ushtarakëve në përgjithësi, aktivë, rezervë dhe në lirim, në pension dhe veteranë, si dhe të familjeve të tyre kudo që ndodhen*”. Ai arrin të justifikojë interesin e tij për shkak se aktet që kundërshtohen prekin drejtpërdrejt të drejtën e tij për të përfituar sigurimin shoqëror suplementar. Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson se kërkuari legjitimohet për ta vënë atë në lëvizje, sepse objekti i akteve që kundërshtohen si antikushtetuese është përcaktimi i përfituesve, masës, kritereve dhe procedurës së përfitimit të sigurimeve shoqërore suplementare të ushtarakëve të liruar, anëtarë të kësaj organizate.

2. Mbi pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike

16. Kërkuari pretendon se nëpërmjet akteve që kundërshtohen është ulur përfitimi nga sigurimi shoqëror suplementar, pasi ligji ka ndryshuar mënyrën e përllogaritjes së tij. Kërkuari pretendon se rregullimi i ri i bërë nga Këshilli i Ministrave, miratuar me ligj të Kuvendit, pas daljes së vendimit nr. 33/2010 të Gjykatës, e ka ulur masën e përfitimit të pensionit suplementar. Sipas tij, shkak për këtë është bërë vendosja e pagës referuese mujore *neto*, gjë që, sipas përllogaritjeve, ka çuar në zvogëlimin e masës së pensionit suplementar që i takon të përfitojë.

17. Gjykata vëren se, referuar kreut II shkronja A të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 793, datë 24.9.2010 “*paga mujore referuese është paga bazë mujore për gradë dhe shtesat mbi pagë me karakter të përhershëm ose paga mujore bazë për funksion dhe shtesat, e cila zbatohet për të njëjtën gradë a funksion në datën kur personave përfitues u lind e drejta për përfitim*”. Kjo dispozitë

ka ndryshuar sipas nenit 2 shkronja E e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 9.2.2011 që parashikon se “paga mesatare referuese, e përcaktuar dhe e llogaritur sipas shkronjave “a” deri në “dh” të këtij kreu, kthehet në pagë mesatare referuese neto, pas zbritjes së shumës së kontributit të detyrueshëm të sigurimit shoqëror; kontributit të detyrueshëm të sigurimit shëndetësor; tatimit mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimit suplementar që mbahen nga paga, sipas përcaktimeve të bëra nga legjislacioni në fuqi në kohën kur personit i ka lindur e drejta për përfitim. Paga mesatare referuese neto evidentohet sipas formularit bashkëlidhur.”

18. Po kështu, duke iu referuar nenit 8 të ligjit nr. 9418, datë 20.5.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, paga referuese përkufizohet si “paga bazë mujore për gradë, sipas viteve të shërbimit, së bashku me shtesat që përfiton ushtaraku i së njëjtës gradë në çastin e lindjes së të drejtës së përfitimit.”

19. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se ajo që ka ndryshuar është referimi i përlllogaritjes të vlera neto e pagës. Nga studimi i akteve që kundërshtohen, si dhe deklarimet e palëve gjatë seancës gjyqësore, rezulton qartë se shtimi i fjalës *neto* ka çuar në ulje të masës së përfitimit të pensionit suplementar të ushtarakëve të liruar. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuësit për uljen e masës së pensionit suplementar dhe cenimin e sigurisë juridike është i bazuar.

20. Gjykata rikonfirmon se parimi i sigurisë juridike garanton parashikueshmërinë e sistemit normativ. Nxjerrja e normave juridike nuk i shërben vetëm zgjidhjes së një konflikti të mundshëm apo rregullimit të një situatë të parregulluar më parë. Ky proces duhet të krijojë përshtypjen të subjektet e së drejtës se përmbajtja e normave juridike garanton siguri dhe qëndrueshmëri për të ardhmen. Siguria juridike trajtohet edhe si kusht për vlefshmërinë materiale të një akti, duke garantuar pandryshueshmërinë në parim të akteve normative, ku i kushtohet vëmendje rregullimit të situatave pa ndryshime substanciale në vazhdimësi, pasi në të kundërt do t’i vendosnim subjektet e së drejtës në pozicione të papëlqyeshme dhe të pafavorshme për ta. Përmbledhtazi, ligjvënësi duhet të mbajë parasysh se një situatë të rregulluar më parë, parimisht, mund ta ndryshojë vetëm nëse kjo sjell pasoja pozitive - konkretisht, trajtim më të mirë (financiar ose jo) – për subjektet përfituese dhe jo kur ndryshimi i akteve ligjore e përkeqëson situatën pra, kur i heq subjekteve përfituese një të drejtë të fituar më parë. Megjithatë, kjo Gjykatë ka theksuar se parimi i sigurisë juridike nuk mund të prevalojë në çdo rast. Kjo do të thotë se nëse paraqitet rasti që një rregullim ligjor i ndryshëm i një marrëdhënieje ndikohet drejtpërdrejt nga një interes publik, me të gjitha elementet e tij thelbësore, ky interes natyrshëm do të ketë përparësi ndaj parimit të sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 26/2005; nr. 10/2008; nr. 33/2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Kushtetuta nuk ndalon çdo ndryshim të një situatë të favorshme ligjore. Kështu, në këtë drejtim, duhet parë në çdo rast se në çfarë mase dhe deri ku, besimi që ka qytetari në situatën e favorshme ligjore paraqitet i rëndësishëm për t’u mbrojtur nga normat dhe parimet kushtetuese, si dhe cilat janë arsyet për një mbrojtje të tillë. Ligjvënësi ka detyrimin të rregullojë në mënyrë më të hollësishme të drejtat e parashikuara në Kushtetutë. Në kuadrin e këtij rregullimi ai nuk mund të prekë ato të drejta, kufijtë e të cilave në Kushtetutë janë parashikuar shprehimisht si të pacenueshme. Të drejtat e tjera kushtetuese ai mund t’i kufizojë vetëm në kushtet e nenit 17 të Kushtetutës, pra për një interes publik, për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve me mënyra dhe forma që të jenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar ndryshimin dhe pa prekur thelbin e së drejtës. Rastet e kufizimit të të drejtave themelore nga ligjvënësi, gjatë marrjes së masave të ndryshme legjislative me qëllim mbrojtjen e një interesi publik, mund të çojnë në cenim të parimit të sigurisë juridike, i cili nuk mund të prevalojë ndaj të parit. Për këtë arsye, Gjykata, në rastin konkret, duhet të analizojë nëse ndërhyrja e ligjvënësit ka qenë e nevojshme, pra e diktuar nga një interes publik, e arsyeshme dhe në përpjesëtim me gjendjen që ka diktuar ndërhyrjen, si dhe nëse ka prekur thelbin e së drejtës.

22. Si kriter i parë i kufizimeve, pas ekzistencës së ligjit në kuptimin formal, gjë e cila në çështjen konkrete rezultoi të jetë respektuar nga ligjvënësi, vjen interesi publik. Koncepti kushtetues



i interesit publik, ashtu siç është trajtuar në praktikë të vazhdueshme nga Gjykata, është mjaft i gjerë dhe duhet parë në këndvështrimin e dispozitës konkrete që paraqitet për kontroll para saj. Është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese çështjet që përbëjnë interes publik ose të arsyes publike që mund të justifikojnë ndërhyrjen në një të drejtë themelore. Ato mund të renditen vetëm negativisht, pra në aspektin e kufizimit të çdo rasti konkret. Në këtë mënyrë, pajtueshmëria e masës kufizuese të marrë nga ligjvënësi me praninë ose jo të nevojës së kufizimit duhet të verifikohet në aspektin e kushteve të vendosura nga neni 17/1 i Kushtetutës dhe konkretisht të ekzistencës së interesit publik.

23. Në çështjen në shqyrtim para kësaj Gjykate, përfaqësuesja e subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, theksoi se arsyet përse u bë ndërhyrja në përlllogaritjen e pensioneve suplementare të grupit të përfaqësuar nga kërkuesi ishin: a) efekti i papërballueshëm për buxhetin e shtetit; b) reduktimi i borxhit publik; c) presioni negativ i krizës globale financiare; ç) konsolidimi fiskal i qeverisë; d) funksionimi normal i skemës së sigurimeve shoqërore; dh) natyra e sigurimit shoqëror suplementar. Këto argumente, të cilat u vlerësuan në dritën e interesit publik dhe nevojës për ndërhyrje të ligjvënësit dhe ekzekutivit në të drejta të fituara më parë, Gjykata i konsideron si shkaqe të arsyeshme dhe proporcionale, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës.

24. Në praktikën kushtetuese është pranuar tashmë se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë (*Shih vendimet nr. 10/2008; nr. 16/2008; nr. 12/2010; nr. 18/2010; nr. 4/2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çështjen konkrete, Gjykata vlerëson se interesi publik, së pari, është i lidhur drejtpërdrejt me mirëfunksionimin e buxhetit të shtetit dhe mbajtjen në kontroll të borxhit publik nga qeveria. Kjo e fundit është përgjegjëse për stabilitetin ekonomiko-financiar të vendit dhe për këtë arsye ka detyrimin të ndërhyjë në çdo rast kur një gjë e tillë rrezikon të përkeqësohet. Qëndrueshmëria e buxhetit të shtetit është e rëndësishme të garantohet në çdo kohë, por ajo merr një rëndësi të veçantë gjatë periudhave të vështira që diktohen nga kriza ekonomike globale, prej së cilës nuk mund të përjashtohet sistemi ekonomiko-financiar shqiptar. Parë në këtë këndvështrim, është në interesin e të gjithë shtetasve marrja e çdo mase të nevojshme ekonomiko-financiare me qëllim shmangien e rreziqeve potenciale të mosfunksionimit të skemës së buxhetit shtetëror. Gjykata rithekson se mbajtja në kontroll e borxhit publik dhe në këtë mënyrë dhe e pasojave të krizës financiare globale, e cila nuk mund të mos ndikojë edhe buxhetin e shtetit shqiptar, është arsye legjitime dhe proporcionale për të ndërhyrë në skemën e sigurimeve suplementare.

25. Së dyti, në funksion të qëndrueshmërisë së buxhetit të shtetit dhe borxhit publik, Gjykata thekson se sistemi i sigurimeve shoqërore konsiderohet “i hapur”, që nënkupton se ndryshimet janë jo vetëm të pranueshme, por edhe të pashmangshme. Sistemi i sigurimeve shoqërore, për shkak të karakterit të tij të gjerë dhe të hapur dhe mënyrës së funksionimit, nuk i jep mundësi individit të kërkojë modifikimin e këtij sistemi, edhe në rastet kur për shkak të këtij sistemi individit mund t’i vijnë pasoja jo të favorshme. Duke qenë e lidhur drejtpërdrejt me buxhetin e shtetit, përgjegjësia për mirëfunksionimin e skemës së sigurimeve shoqërore është kompetencë ekskluzive e ligjvënësit në bashkëpunim me ekzekutivin. Natyrisht, është e pritshme që ndërhyrja e ligjvënësit në çdo rast të bëhet duke iu përmbajtur kufijve të Kushtetutës. Iniciativa e ligjvënësit në këtë fushë mbetet veçanërisht e gjerë. Faktorët që nxisin ndryshimet në sistemin e sigurimeve shoqërore mund të jenë çështje me interes të gjerë publik, si: përpjekja për ta bërë sa më të drejtë sistemin për të dyja palët (përfitues dhe kontribues), situata financiare e buxhetit, si dhe faktorë të tjerë socialë. Ndërhyrjet që mund t’i bëhen sistemit të pensioneve duhet t’i shërbejnë konsolidimit të tij dhe stabilitetit ekonomiko-financiar me qëllim funksionimin e skemës së pensioneve sipas parimit që gjithkush ka të drejtën e përfitimit të një sigurimi sa më të mirë e të përshtatshëm me mënyrën e jetesës (*shih vendimet BVerfGE 11, 221; BVerfGE 76, 220 të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane.*)

26. Së treti, Gjykata vlerëson se natyra e sigurimit shoqëror suplementar është e ndryshme nga sigurimi shoqëror bazë. Qëllimi i të parit është shmangia e pasojave negative në ushtrimin e funksionit të një kategorie të caktuar të punonjësve, si dhe garantimi e ruajtja e të ardhurave për

sigurimin e nevojave jetike të tyre. Ndërsa sigurimi shoqëror bazë është një e drejtë kushtetuese ekonomiko-sociale dhe si e tillë lidhet me detyrimin e shtetit për të qenë aktiv e për t'u garantuar shtetasve sigurimin e mjeteve të përshtatshme për nevoja jetësore në rastet e fatkeqësive, sëmundjeve, invaliditetit, pleqërisë dhe papunësisë së padëshiruar (*shih vendimet nr. 33/2010 dhe 9/2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Për këtë arsye, ndryshimi i skemës së përfitimeve suplementare mbetet në diskrecion të politikave dhe mundësive të ekzekutivit, kurse prekja e skemës së sigurimeve shoqërore bazë nuk duhet kurrsesi të pësojë ndryshime të tilla që të përkeqësojë ndjeshëm jetën e shtetasve që përfitojnë këtë sigurim. Nisur nga sa më lart, Gjykata vlerëson se gjendet para interesit publik që e justifikon ndërhyrjen e ligjvënësit në skemën e sigurimeve suplementare.

27. Gjykata rithekson, gjithashtu, se një kusht tjetër që duhet të respektojë ligjvënësi gjatë ndërhyrjes në një situatë të rregulluar më parë është edhe respektimi i raportit të drejtë midis ndërhyrjes dhe gjendjes/situatës që e ka diktuar atë. Ky kusht e imponon ligjvënësin të evidentojë nevojën reale të ndërhyrjes në të drejtat individuale në një situatë konkrete. Baraspeshimi i ndërhyrjes me gjendjen që e ka diktuar atë imponon ligjvënësin të zbatojë mjete të tilla ligjore, të cilat duhet të jenë efektive, d.m.th. të zgjedhura në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që kërkohet të arrihen. Gjithashtu, Gjykata, në jurisprudencë të vazhdueshme, ka mbajtur qëndrimin se parimi i proporcionalitetit nënkupton që ndërhyrja e ligjvënësit për kufizimin e një të drejte ose lirie të caktuar të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet (*shih vendimet nr. 10/2008; nr. 4/2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Përveç kësaj, përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, çka do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria ka të bëjë, gjithashtu, edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë. Kushti i përpjesëtimit të kufizimit me gjendjen që e ka diktuar, konkretizohet në kërkesën e domosdoshmërisë, të dobishmërisë dhe të proporcionalitetit. Respektimi i këtyre kushteve kërkon një analizë të kujdesshme në çdo rast konkret, duke ballafaquar interesin publik që dikton kufizimin me të drejtat që kufizohen. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se respektimi i përmbushjes së kushteve të mësipërme të kufizimit kërkon një trajtim të diferencuar, në varësi të të drejtave dhe lirive individuale që i nënshtrohen kufizimit (*vendimi nr. 16/2008 i Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në këndvështrim të këtyre kritereve kushtetuese, Gjykata vlerëson se në çështjen në shqyrtim është evidente se masa e përfitimit të sigurimit suplementar është zvogëluar si pasojë e vendosjes si pagë referuese pagën mujore neto. Kjo u pranua edhe nga subjektet e interesuara, Kuvendi, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Financave, gjatë seancës plenare të zhvilluar para kësaj Gjykate. Sipas tyre, kjo ulje ishte bërë si rezultat i mosfunksionimit sipas parimeve bazë të skemës së pensioneve duke sjellë si pasojë që vlera financiare e fondit të pensionit për këtë kategori përfituesish të ishte jo vetëm e papërbalueshme për buxhetin e shtetit, por edhe joreale, pasi personat që dilnin në pension të parakohshëm merrnin një pension të përafërt me pagën reale që përfitonin duke qenë në marrëdhënie pune. Për këtë arsye, ishte e domosdoshme që, me iniciativën e Këshillit të Ministrave, të përllogaritej masa e pensionit suplementar duke mbajtur parasysh raportet e drejta shërbim/pagë dhe shërbim/pension. Sipas subjekteve të interesuara, në rast se pensionet e ushtarakëve të liruar do të vazhdonin të përllogariteshin me skemën para hyrjes në fuqi të akteve objekt shqyrtimi, kjo do të sillte një efekt të papërbalueshëm për buxhetin e shtetit dhe cenimin e parimit të barazisë midis subjekteve të ndryshme që përfitonin pension të parakohshëm.

29. Gjykata çmon se aktet objekt shqyrtimi respektojnë raportin e drejtë midis interesit publik dhe garantimit të mirëfunksionimit të buxhetit publik, i cili do të pësonte një goditje të konsiderueshme nëse nuk bëhej ndërhyrja në skemën e pensioneve. Aktet që kundërshtohen nuk mohojnë të drejtën për përfitimin e sigurimit suplementar, ato vetëm bëjnë një përllogaritje, e cila është reale dhe e arsyeshme në raport me të gjithë kategoritë e subjekteve përfituese, duke respektuar në këtë mënyrë edhe parimin e barazisë mes përfituesve. Gjykata vlerëson se, megjithëse



skema e re e llogaritjes së masës së sigurimit suplementar ka sjellë uljen e të ardhurave për përfituesit, kjo ndërhyrje është në përpjesëtim të drejtë me qëllimin që e ka diktuar atë. Siç u tha më lart, qëllimi që kërkon të arrijë ekzekutivi/ligjvënësi me anë të rregullimit të ri është mbajtja e skemës së sigurimeve brenda parimeve bazë të saj, pra të raporteve të drejta dhe të arsyeshme midis masës së sigurimit të parakohshëm dhe pagës mesatare neto nga puna. Diferencimet që ekzistojnë para kësaj ndërhyrjeje cenonin parimet dhe rregullat në fushën e pagave dhe të tatimit mbi të ardhurat personale, si dhe shkaktonin një detyrim të papërbalueshëm për buxhetin e shtetit duke e rrezikuar atë seriozisht. Gjykata konstaton se masa e pensionit e përlllogaritur sipas formulës së re mbështetet në mundësitë reale buxhetore, ajo siguron respektimin e parimeve të funksionimit të skemave suplementare, si dhe ruajtjen e raporteve të arsyeshme midis pensionit suplementar të ushtarakëve, atij të pleqërisë dhe pagës neto nga puna. Në këtë këndvështrim, edhe pretendimi i kërkuar se vendimi nr. 33/2010 i Gjykatës Kushtetuese nuk është zbatuar, është i pabazuar, pasi në çështjen në shqyrtim, shkaqet për të cilat subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka vendosur ndryshimin e formulës përlllogaritëse të pensionit suplementar janë të ndryshme nga ato të paraqitura në çështjen e gjykuar në vitin 2010. Këto shkaqe u analizuan më sipër nga Gjykata.

30. Nisur nga sa më lart, Gjykata çmon se, megjithëse parimi i sigurisë juridike është prekur nga rregullimi i ri, kjo ndërhyrje është bërë duke respektuar kriteret kushtetuese për këtë qëllim të parashikuar nga neni 17/1 i Kushtetutës, konkretisht mbrojtjen e interesit publik, vendosjen e një raporti të drejtë midis së drejtës së cenuar dhe qëllimit që synohet të arrihet nëpërmjet ndërhyrjes legislative, si dhe ruajtjen e thelbit të së drejtës për sigurim shoqëror.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/a, 134/1/f të Kushtetutës dhe neneve 49/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Sokol Berberi, Xhezair Zaganjori, Fatmir Hoxha

VENDIM

Nr. 3, datë 19.2.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Xhezair Zaganjori	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Admir Thanza	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 8.11.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen nr. 38/12 Akti, që i përket:

KËRKUES: Nikolaos Vagenas, përfaqësuar nga avokat Reshit Trungu, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Vangjel Xhamo, përfaqësuar nga avokat Zhulien Ristani, me deklaram në seancë.

Shoqëria Vjosa sh.a., në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr. 1100, datë 30.9.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe i vendimit nr. 00-2011-01, datë 13.1.2012 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15/1, 16/1, 17, 23/1, 42/2, 131/f, 134/1/g, 142/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ); nenet 27-31 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, përfaqësuesin e kërkuarit që u shpreh për pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, Vangjel Xhamo, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuarisi Nikolaos Vagenas dhe subjekti i interesuar, Vangjel Xhamo, janë aksionarë të shoqërisë “Omegas Energy” sh.a., me objekt veprimtarie tregtimi i gazit të lëngshëm.

2. Subjekti tjetër i interesuar, shoqëria “Vjosa” sh.a., po me objekt veprimtarie tregtimi i gazit të lëngshëm, me qëllim furnizimin me gaz, ka lidhur me shoqërinë amerikane “Alfagas International” LLC, kontratën “Ofertë për LPG”, ku janë përcaktuar kushtet e furnizimit me gaz dhe mënyra e pagesës së tij. Për këtë qëllim, në datë 12.12.2003, shoqëria “Vjosa” sh.a. ka paguar nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, në favor të shoqërisë amerikane të lartpërmendur, në numrin e llogarisë së kësaj të fundit pranë Piraeus Bank SA, Athinë, Greqi, shumën prej 115 000 USD. Pavarësisht pagesës së kryer, shoqëria amerikane “Alfagas International” LLC nuk ka përmbushur detyrimin e saj ndaj shoqërisë “Vjosa” sh.a.

3. Subjekti i interesuar, Vangjel Xhamo, pretendon se marrëdhënia kontraktore e përmendur në nr. 2 të këtij vendimi, efektivisht, është krijuar ndërmjet kërkuarit Nikolaos Vagenas, i cili vepronte në cilësinë e menaxherit të shoqërisë amerikane, dhe shoqërisë “Vjosa” sh.a. dhe se Vangjel Xhamo ka qenë në dijeni të saj për shkak të qenies ortakë me z. Nikolaos Vagenas. Po ashtu, Vangjel Xhamo parashtron se me kërkesë të bashkaksionerit Nikolaos Vagenas dhe për llogari të tij, i ka paguar shoqërisë “Vjosa” sh.a. shumën në fjalë, si detyrim i kërkuarit ndaj kësaj shoqërie për mosrealizimin e furnizimit të porositur.

4. Shuma e paguar në favor të shoqërisë “Vjosa” sh.a., nuk është shlyer nga debitori (kërkuarisi), pavarësisht kërkesave të z. Vangjel Xhamo. Për këtë arsye, ky i fundit i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, bazuar në nenet 419, 420, 445, 446 të Kodit Civil (KC) dhe në nenin 32/a të Kodit të Procedurës Civile (KPC), me objekt detyrimin e Nikolaos Vagenas t’i paguajë shumën prej 115 000 USD dhe kamatëvonesat deri në datën e ngritjes së padisë. Në këtë gjykim është thirrur si person i tretë shoqëria “Vjosa” sh.a.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3203, datë 9.4.2008, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadiës si të pambështetur në prova dhe në ligj. Ajo ka arsyetuar se pala paditëse nuk ka arritur të provojë detyrimin që kërkuarisi (i padituri në atë gjykim), ka pasur ndaj shoqërisë



“Vjosa” sh.a.

6. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim z. Vangjel Xhamo dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1100, datë 30.9.2009 ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 3203, datë 9.4.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e kërkuarit Nikolaos Vagenas të paguajë në favor të paditësit shumën totale prej 120 343 USD. Gjykata e apelit ka arsyetuar se nga dokumentet e paraqitura nga pala paditëse, Vangjel Xhamo, provohet se z. Nikolaos Vagenas është përfaqësues dhe drejtor i përgjithshëm i “Alfagas International” LLC dhe se ai ka pasur detyrimin për pagesën e shumës ndaj shoqërisë “Vjosa” sh.a.

7. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs kërkuari duke pretenduar se gjykata ka vendosur në kundërshtim me ligjin material dhe procedural, si dhe me provat e paraqitura nga palët, të cilat, sipas tij, nuk provojnë detyrimin e kërkuarit ndaj shoqërisë “Vjosa” sh.a., por përkundrazi provojnë marrëdhëniet e mëparshme ndërmjet shoqërisë “Vjosa” sh.a. dhe “Alfagas International” LLC. Ai parashtron se pavarësisht kërkesave të tij, gjykata e apelit nuk ka thirrur në gjykim shoqërinë amerikane “Alfagas International” LLC. Në këtë mënyrë gjykata ka shkelur normat procedurale në lidhje me ndërgjyqësinë, kompetencën dhe juridiksionin.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2011-01, datë 13.1.2012, ka vendosur, në dhomë këshillimi, mospranimin e rekursit me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së.

II

Pretendimet – parashtruar Gjykatës Kushtetuese

9. Kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë. Ai ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:

9.1 Gjykata e Apelit Tiranë ka cenuar të drejtën për një gjykim të drejtë nga një gjykatë e paanshme për shkak se ka vendosur në kundërshtim me provat e paraqitura nga palët dhe me ligjin material dhe procedural. Gjithashtu ajo ka shkelur normat procedurale në lidhje me ndërgjyqësinë, kompetencën dhe juridiksionin.

9.2 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, edhe pse në prezencë të dy vendimeve gjyqësore me qëndrime të ndryshme nga njëri-tjetri, duke vendosur moskalimin e rekursit për shqyrtim në seancë gjyqësore ka cenuar të drejtën e ankimit efektiv në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës, si dhe të drejtën e kërkuarit për t’u dëgjuar para se të gjykohet.

9.3 Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar nenin 142/1 të Kushtetutës që sanksionon detyrimin e arsyetimit të vendimit, pasi ky vendim nuk arsyeton shkaqet e mospranimit të tij, edhe pse nga kërkuari janë pretenduar shkelje të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat më të ulëta, si dhe shkaqe të parashikuara nga neni 472 i KPC-së.

10. **Subjekti i interesuar**, Vangjel Xhamo, gjatë gjykimit parashtroi se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë zhvilluar një proces të rregullt ligjor, duke prapësuar se:

10.1 Vlerësimi i provave dhe mënyra e zgjidhjes së çështjes mbi bazën e tyre është kompetencë ekskluzive e gjykatave të sistemit gjyqësor dhe në këtë drejtim Gjykata nuk mund të marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuarit për vlerësim të gabuar të provave e zgjidhje të padrejtë të çështjes. Si rrjedhojë, është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që t’i japin një zgjidhje të caktuar konfliktit të paraqitur duke analizuar provat e administruara në gjykim dhe duke i vlerësuar ato në tërësinë e tyre. Fakti që gjykata e apelit nuk ka pranuar pretendimet e kërkuarit në lidhje me ndërgjyqësinë, juridiksionin dhe kompetencën nuk do të thotë që kësaj pale i janë shkelur të drejtat për një proces të rregullt ligjor sepse pretendimet e saj janë dëgjuar, shqyrtuar dhe rrëzuar nga gjykata në bazë të ligjit. Po ashtu, në këtë këndvështrim, nuk qëndron dhe pretendimi i kërkuarit mbi cenimin e parimit të paanshmërisë së gjykatës së apelit, pasi sipas jurisprudencës së Gjykatës ky nocion ka të bëjë kryesisht me përbërjen e trupit gjykues.

10.2 Kërkuesit nuk i është cenuar e drejta e ankimit efektiv në kuptim të nenit 42 dhe 43 të Kushtetutës. Fakti që rekursi i paraqitur nga kërkuesi nuk është pranuar nga Kolegji Civil në Dhomë Këshillimi nuk do të thotë *a priori* që atij i është shkëlur e drejta e tij për të pasur një ankim efektiv dhe të vërtetë. Shkaqet e paraqitura nga kërkuesi ngrenë probleme që lidhen me vlerësimin e provave dhe që nuk kanë të bëjnë me natyrën e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë. Për këtë arsye, me të drejtë Kolegji Civil në Dhomën e Këshillimit ka vendosur mospranimin e rekursit.

10.3 Gjykata e Apelit Tiranë dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë kanë respektuar standardin e arsytimit të vendimit pasi vendimet e këtyre gjykatave janë në përputhje të plotë me përcaktimet e KPC-së dhe të nenit 142 të Kushtetutës. Ato mbështeten mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor, përmbajnë bazën dhe analizën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Veçanërisht për gjykimin e çështjes nga Gjykata e Lartë, sipas jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), kërkesat e nenit 6 të KEDNJ-së mund të plotësohen edhe me një arsytim shumë të kufizuar.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

11. Në analizën e pretendimeve të kërkuesit, Gjykata sheh të arsyeshme të theksojë, paraprakisht, se ajo i vlerëson këto pretendime në drejtim të standardeve që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, në aspektin e detyrimeve që i ngarkon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm respektimi i standardeve kushtetuese.

12. Gjykata ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 31, datë 5.7.2011; nr. 22, datë 22.7.2009 dhe nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Nisur nga kjo premisë, si dhe nga objekti i mosmarrëveshjes ndërmjet palëve, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit se Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur në kundërshtim me provat e paraqitura nga palët dhe me ligjin, si dhe ka shkëlur normat procedurale në lidhje me ndërëgjyqësinë, kompetencën dhe juridiksionin ka të bëjë me vlerësimin e provave, mënyrën e interpretimit të fakteve dhe të zbatimit të ligjit nga ana e gjykatës së apelit. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se ky pretendim nuk hyn në juridiksionin kushtetues përderisa kërkuesi nuk ka përcaktuar se cilat standarde kushtetuese i janë cenuar si rezultat i këtij interpretimi apo shkeljeje.

14. Ndërsa, për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të paanshmërisë nga ana e gjykatës së apelit, Gjykata, në jurisprudencën e saj, edhe nën dritën e jurisprudencës së GJEDNJ-së, ka analizuar dhe ka dhënë përkufizimet e nevojshme mbi nocionin “*gjykatë e paanshme*” duke theksuar se ky parim ka të bëjë kryesisht me përbërjen e trupit gjykues. Për këtë arsye, Gjykata vëren se pretendimi i kërkuesit për cenimin e këtij parimi bazuar në mënyrën e vlerësimit të provave dhe interpretimit të ligjit procedural është i pabazuar.

15. Për pasojë, në vijim, Gjykata vlerëson të ndalet vetëm në pretendimin për (mos)arsyetimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe të cenimit të së drejtës së ankimit.

A. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, si dhe së drejtës së ankimit

16. Sipas kërkuesit, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk është i arsytuar pasi nuk paraqiten shkaqet e mospranimit të rekursit të tij, edhe pse nga kërkuesi janë pretenduar shkelje të standardeve



kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat më të ulëta, si dhe shkaqe të parashikuara nga neni 472 i KPC-së.

17. Gjykata ripohon se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42, 142/1 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 25, datë 10.6.2011 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 11, datë 2.4.2008 dhe nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 20, datë 13.4.2012 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjithsesi, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjithë elementet e sipërpërmendur. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsytimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsytimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe, në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Po në këtë drejtim, neni 310/1 i KPC-së parashikon se vendimi i gjykatës duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese, duke përcaktuar, në paragrafët e tjerë, elementet që duhet të përmenden në secilën prej këtyre pjesëve. Ndërsa për gjykimin në Gjykatën e Lartë, KPC-ja sanksionon se rekursi, ndër të tjera, duhet të përmbajë shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, duke iu referuar normave ligjore mbi të cilat mbështetet (neni 475/ç) dhe se shqyrtimi i çështjes në kolegjet seleksionuese konsiston në një vlerësim të këtyre shkaqeve. Nëse rekursi bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që i lejon ligji ai nuk pranohet dhe mospranimi i tij vendoset nga kolegji i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit (neni 480).

23. Nga parashikimet e dispozitave të KPC-së të lartpërmendura (§ 21 i këtij vendimi), si dhe bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj, Gjykata çmon se në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë, si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsytimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të elaboruara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar.

24. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi i mospranimit i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përmban, në pjesën hyrëse të tij objektin e padisë, disponimet e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit dhe faktin se kundër vendimit të kësaj të fundit ka paraqitur rekurs kërkuesi, por nuk përmban shkaqet që ai ka parashtruar në rekurs. Ndërsa në pjesën arsyetuese, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është mjaftuar me përfundimin se rekursi i paraqitur nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së duke vendosur, në pjesën urdhëruese, mospranimin e tij. Pra, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pavarësisht se në vendim nuk paraqet cilat janë shkaqet e kundërshtimit të vendimit të apelit, ka arritur të bëjë një proces vlerësimi të tyre (shkaqeve) nëpërmjet të cilit ka arritur në konkluzionin e shprehur në dispozitiv.

25. Nga leximi në tërësi i vendimit, Gjykata vlerëson se, për shkakun e lartpërmendur, rrjedha logjike e përdorur në vendim nuk rezulton e qartë dhe e kuptueshme dhe se argumentet e pjesës hyrëse nuk janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe atë urdhëruese. Ato nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, çka bën që përmbajtja dhe arsytimi i tij të mos ketë një harmoni të brendshme. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs, në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përbën një të metë, të pakapërcyeshme, të përmbajtjes së vendimit dhe të arsytimit të gjykatës.

26. Gjykata, nisur dhe nga sa u argumentua më lart, çmon gjithashtu se, *prima facie*, mosparaqitja, në vendimin e Kolegjit Civil, të shkaqeve të parashtruara nga kërkuesi në rekurs, krijon dyshime edhe mbi cenimin e së drejtës së ankimit efektiv, si dhe të së drejtës për t'u dëgjuar, të pretenduara nga kërkuesi. Në këtë këndvështrim, pasqyrimi i shkaqeve të rekursit në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë përbën një element të domosdoshëm dhe të rëndësishëm të tij, i cili nuk ka thjesht karakter formal në përmbajtjen e vendimit gjyqësor.

27. Si përfundim, nisur nga sa më sipër, Gjykata çmon se vendimi i mospranimit të rekursit i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsytimit të vendimeve gjyqësore. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit në këtë aspekt është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134 pika 1 shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,



VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2011-01, datë 13.1.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë¹.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Admir Thanza, Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo

Anëtar kundër: Xhezair Zaganjori

MENDIM PARALEL

1. Në çështjen me kërkues Nikolaos Vagenas, pajtohem me vendimin e shumicës për pranimin pjesërisht të kërkesës, shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 00-2011-01, datë 13.1.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, por kemi mendim të ndryshëm lidhur me arsyet e këtij qëndrimi.

2. Shumica, në thelb, ka argumentuar se vendimi i moskalimit, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke mos pasqyruar në pjesën hyrëse të tij shkaqet e parashtruara nga kërkuesi në recurs, nuk përmbush detyrimet e sanksionuara nga dispozitat procedurale të KPC-së, si dhe ato të elaboruara nga jurisprudenca kushtetuese lidhur me elementet përbërëse të vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, shumica ka çmuar se vendimi në fjalë, për shkakun e lartpërmendur, krijon dyshime për cenimin e së drejtës së ankimit efektiv, por pa i dhënë përgjigje konkrete këtij pretendimi të kërkuesit. Në përfundim të vlerësimit të saj, shumica ka arritur në konkluzionin se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar standardin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

3. Ndonëse shumica, duke iu referuar jurisprudencës së kësaj Gjykate, ka pranuar se nuk mjafton që arsyetimi i një vendimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv (shih paragrafin 20 të vendimit), ajo nuk ka mundur t'i shmanget vetë këtij formalizmi në arsyetimin e shkaqeve për të cilat ka vendosur shfuqizimin e vendimit në fjalë. Korrigjimi i mangësisë së konstatuar nga shumica, nga ana e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, pra paraqitja në vendimin e mospranimit të Gjykatës së Lartë të shkaqeve të ngritura në recurs nga kërkuesi, objektivisht nuk do të passjellë asnjë rezultat konkret në realizimin e së drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor. Vendimi i Gjykatës së Lartë, pasi të ketë përmbushur detyrimet që burojnë nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese, rrezikon të mbetet përsëri objekt kundërshtimi kushtetues. Nga ky këndvështrim, veç sa më sipër, formalizmi në vendimmarrjen e kësaj Gjykate mund të krijojë një shqetësim të ri lidhur me efektivitetin e vendimeve të saj.

4. Në këtë drejtim, jemi të mendimit se, fillimisht, shumica duhet t'i jepte përgjigje pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi.

5. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në

¹ Gjyqtarët V. Kristo dhe A. Xhoxhaj janë shprehur me mendim paralel.

bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 4, datë 28.2.2006 dhe nr. 19, datë 2.4.2012*).

Në vijim të këtij vlerësimi, më poshtë, do t'i përgjigjemi pretendimeve të ngritura nga kërkuesi.

6. Për sa i përket pretendimit për shkeljen e normave procedurale në lidhje me ndërgjyqësinë, kompetencën dhe juridiksionin, kërkuesi ka parashtruar se gjykata e apelit nuk e ka krijuar drejt ndërgjyqësinë dhe se ajo duhet të ndërpriste gjykimin për shkak të mungesës së juridiksionit dhe kompetencës. Kjo për arsyen se palët, shoqëria “Vjosa” sh.a. dhe ajo amerikane “Alfagas International” LLC, në dokumentin (ofertë për LPG), ku janë përcaktuar kushtet e furnizimit me gaz të lëngshëm dhe mënyra e pagesës së këtij furnizimi, kanë rënë dakord që mosmarrëveshjet midis tyre do të gjykohen sipas ligjit anglez dhe se gjykimi do të bëhet në Mbretërinë e Bashkuar, si vend neutral. Po ashtu, sipas kërkuesit, fakti se nuk është thirrur si palë ndërgjyqëse në gjykim shoqëria “Alfagas International” LLC, e bën procesin të parregullt në aspektin kushtetues, duke dëmtuar në këtë mënyrë thelbin e vetë procesit. Në këtë drejtim, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje këtij pretendimi, edhe pse nga kërkuesi është pretenduar një shkelje e rëndë procedurale, bazuar në nenin 472/1/b të KPC-së në lidhje dhe me nenin 467 të KPC-së.

7. Në jurisprudencën e Gjykatës, mosformimi i drejtë i ndërgjyqësisë është cilësuar si shkelje e standardeve për një proces të rregullt ligjor dhe është analizuar në funksion të cenimit të parimit të kontradiktoritetit në gjykim, si dhe të barazisë së armëve (*shih vendimet nr. 14, datë 15.4.2003 dhe nr. 13, datë 18.5.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin civil, është një evolucion logjik i së drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi, për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues, për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 33, datë 24.11.2003; nr. 16, datë 8.6.2006; nr. 13, datë 21.7.2008; nr. 30, datë 26.11.2009; nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 34, datë 25.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Gjithsesi, Gjykata ka vlerësuar se pretendimi i mosformimit të drejtë të ndërgjyqësisë duhet analizuar edhe në aspektin e lidhjes së drejtpërdrejtë që ka ekzistenca e shkeljes ligjore me vetë kërkuesin, si dhe të ndikimit që kjo shkelje mund të ketë sjellë mbi ecurinë e procesit gjyqësor (*shih vendimin nr. 13, datë 18.5.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në rastin në shqyrtim, objekt i procesit gjyqësor është kërkimi për përmbushjen e një detyrimi monetar, të lindur fillimisht ndërmjet shoqërive “Vjosa” sh.a. dhe “Alfagas International” LLC, ndërkohë që kjo e fundit nuk është thirrur si palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor. Në këto kushte, jemi të mendimit se pretendimi i kërkuesit se në shqyrtimin e konfliktit duhet të merrte pjesë edhe shoqëria “Alfagas International” LLC, sepse formimi i drejtë i ndërgjyqësisë përbënte kusht të domosdoshëm për rregullsinë e procesit gjyqësor, duhet të merrte përgjigje në vendimin e Gjykatës së Lartë, përderisa ai i referohet shkaqeve të parashikuara nga neni 472/1/b i KPC-së. Për më tepër, kur një pretendim i tillë është i lidhur me respektimin e parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në procesin gjyqësor.

10. Kërkuesi, gjithashtu, ka pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, edhe pse në prezencë të dy vendimeve gjyqësore me qëndrime të ndryshme nga njëri-tjetri, duke vendosur moskalimin e rekursit për shqyrtim në seancë gjyqësore, i ka mohuar atij të drejtën e ankimit efektiv në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës, si dhe të drejtën për t'u dëgjuar para se të gjykohet.



11. Neni 43 i Kushtetutës parashikon se “*kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe*”. Në jurisprudencën e kësaj Gjykate, e drejta e ankimit është vlerësuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar atij (individit) të drejtën për t’u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj (*shih vendimet nr. 5, datë 2.3.2010; nr. 12, datë 14.4.2010; nr. 14 datë 26.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Pra, me Kushtetutë, kujtdo i garantohet e drejta për t’u ankuar të paktën një herë kundër çdo vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij. Kjo garanci e rëndësishme kushtetuese është edhe një tejkalim pozitiv krahasuar me standardet që ofron në këtë drejtim Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (*shih vendimet nr. 14, datë 5.7.2005; nr. 12, datë 14.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata ka pohuar se e drejta e ankimit, e sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës, është një e drejtë procedurale që shërben për të mbrojtur një të drejtë substanciale. Kjo e drejtë bazohet në parimin se “*...nuk mund të ekzistojë një e drejtë pa të drejtën e ankimit*” (*shih vendimet nr. 12, datë 14.4.2010; nr. 14 datë 26.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit ka rëndësi të realizohet si aspekti formal/procedural ashtu edhe ai substancial. Kërkesat procedurale të ankimit janë, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë individët për të ushtruar efektivisht ankimin ndaj vendimit gjyqësor. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale civile/penale, është pjesë e së drejtës së individit për të pasur akses në gjykatë. Gjykata ka vlerësuar edhe më parë se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 14, datë 3.6.2009 dhe nr. 7 datë 11.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë aspekt, duke iu referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, Gjykata ka çmuar se, veçanërisht, mjetet procedurale të ankimit të ofruara nga legjislacioni i brendshëm dhe praktika duhet të tregojnë se ato kanë qenë efektive (*shih vendimet nr. 30, datë 17.6.2010; nr. 14 datë 26.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Nga sa më sipër, në rastin objekt shqyrtimi, duke qenë se vendimi i gjykatës së apelit, lidhur me themelin e çështjes, ka qenë diametralisht i kundërt me atë të gjykatës së shkallës së parë, me qëllim që kërkuesit t’i garantohej e drejta për t’u ankuar të paktën një herë kundër çdo vendimi gjyqësor të dhënë kundër tij (në rastin konkret ndaj vendimit të gjykatës së apelit që e ka ngarkuar me detyrimin të paguajë shumën e kërkuar) dhe duke konsideruar edhe shkeljet procedurale të konstatuara dhe ngritura në rekurs, në mënyrë që ankimi i kërkuesit të ishte një mjet efektiv, vlerësojmë se gjykimi në Gjykatën e Lartë do të shërbente realisht si një “gjykim apeli” (në shkallë të dytë) dhe se, në këto kushte, duhej vendosur kalimi i çështjes në seancë gjyqësore. Në këtë drejtim, mendojmë se pretendimi i kërkuesit për mohim të së drejtës së ankimit efektiv për shkak të mospranimit të rekursit, është i bazuar.

14. Lidhur me pretendimin e kërkuesit për (mos)arsyetimin e vendimit të mospranimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, Gjykata në jurisprudencën e saj, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit, për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet n. 19, datë 19.7.2005; nr. 22, datë 6.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Nisur nga sa analizuam më lart, në lidhje me vlerësimin tonë për pretendimet e tjera të ngritura nga kërkuesi, çmojmë se ky pretendim i tij është i bazuar.

15. Si përfundim, në kushtet kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e dispozitave procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit, si dhe të parimeve themelore të

procesit të rregullt ligjor, Gjykata e Lartë duhet të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me pretendimet e ngritura nga kërkuesi, si në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit ashtu dhe në kontrollin e respektimin e standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta. Në këto raste, Gjykatës Kushtetuese nuk i mbetet gjë tjetër veçse të vendosë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit përkatës të Gjykatës së Lartë, i cili nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit, duke e “detyruar” atë në këtë mënyrë, të shprehet për arsyet e mospranimit të shkaqeve të ngritura në rekurs.

16. Në këtë këndvështrim, jemi të mendimit se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar kërkuesit të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Anëtarë: Altina Xhoxhaj, Vladimir Kristo

VENDIM

Nr. 4, datë 20.2.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Admir Thanza	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 17.1.2013 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 53/25 Akti, që i përket:

KËRKUES: Raimonda Trupja

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Përgjithshme Detare; Zyra e Përmbaramit Durrës

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesja ka qenë punonjëse pranë Kapitenerisë së Përgjithshme të Porteve Durrës (në vijim “Kapiteneria e Porteve”). Me vendimet nr. 173 prot., datë 22.5.2006 dhe nr. 175 prot., datë 25.5.2006 të Kapitenerisë së Porteve, kërkueses i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare dhe është liruar nga detyra. Këto vendime janë marrë mbi bazën e vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 44, datë 27.1.2006 “Për shmangien e nepotizmit në administratën publike”. Me vendimin nr.



20, datë 11.7.2006, Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar VKM-në nr. 44, datë 27.1.2006 “Për shmangien e nepotizmit në administratën publike”, si të papajtueshëm me Kushtetutën. Në këto rrethana, kërkesja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me padi me objekt “kthimin në punë”.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 2918, datë 12.12.2006, ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë absolute të zgjidhjes së kontratës së punës mes Kapitenerisë së Porteve dhe kërkeses, detyrimin e rikthimit në punë të kërkeses dhe të pagimit të saj për gjithë periudhën e qëndrimit pa punë, duke filluar nga data 31.5.2006 e deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

3. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 540, datë 3.12.2007, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Ky vendim ka marrë formë të prerë dhe, në zbatim të tij, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit nr. 36, datë 21.1.2008.

4. Në datën 7.4.2008, kërkesja, ka depozituar pranë Zyrës së Përmbaramit Durrës (në vijim “Zyra e Përmbaramit”) urdhrin e ekzekutimit dhe kërkesën për zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Edhe pas kryerjes së disa veprimeve përmbarimore nga Zyra e Përmbaramit dhe kërkesave të dërguara nga kërkesja në drejtim të institucioneve shtetërore përkatëse, rezultoi se vendimi gjyqësor i formës së prerë ende nuk është zbatuar.

5. Gjatë kohës së zhvillimit të procesit gjyqësor në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, struktura organizative e Kapitenerisë së Porteve është ndryshuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 255, datë 1.11.2006 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Kapitenerisë së Porteve”. Me anë të urdhrin të Kryeministrit nr. 131, datë 14.6.2010, është miratuar struktura dhe organika e re e Drejtorisë së Përgjithshme Detare (në vijim “Drejtoria Detare”), dhe njëkohësisht është shfuqizuar struktura dhe organika e Kapitenerisë së Porteve, si dhe është suprimuar pozicioni i punës së kërkeses.

6. **Kërkesja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

7. **Subjekti i interesuar**, Drejtoria Detare, në parashtrimet me shkrim, ka pretenduar pamundësinë objektive për të ekzekutuar vendimin e gjykatës pasi vendi i mëparshëm i punës së kërkeses është suprimuar. Për pasojë, sipas këtij institucioni, rikthimi në punë i kërkeses në vendin e mëparshëm është i pamundur të zbatohet.

II

A. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës

8. Kërkesja pretendon se, që prej marrjes formë të prerë të vendimit nr. 540, datë 3.12.2007, të Gjykatës së Apelit Durrës, dhe lëshimit të urdhrin të ekzekutimit nr. 36, datë 21.1.2008, ka kaluar një kohë e gjatë dhe e pajustificuar për ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

9. Gjykata është shprehur edhe më parë se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës, është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individit e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Në këtë fazë duhet të marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar, kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij kundrejt kreditorit. Në raste të tilla, procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave për rastin konkret, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin

e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr. 1, datë 20.1.2012; nr. 2, datë 1.2.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 6, datë 4.3.2010 dhe nr. 43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në vendimmarrjen e saj Gjykata ka pranuar se: "...parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të parashikuara në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj". Më tej, Gjykata ka pohuar se "...ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. ... Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre" (*shih vendimet nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 1, datë 19.1.2009; nr. 43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se, në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuarit, si dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse (*shih vendimet nr. 10, datë 1.3.2012; nr. 21, datë 3.6.2011; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 9, datë 1.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Çështja konkrete është vlerësuar në vijim nga Gjykata në vështrim të respektimit të standardeve të mësipërme.

i) Kompleksiteti i çështjes

13. Në lidhje me kompleksitetin e çështjes, Gjykata ka pohuar vazhdimisht se, për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 7, datë 27.2.2012; nr. 50, datë 22.11.2011; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 9, datë 1.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Çështja në shqyrtim ka për objekt mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, për sa i përket kthimit në punë dhe pagimit të kërkuarës për gjithë periudhën e qëndrimit pa punë, duke filluar nga data 31.5.2006 e deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Duke iu referuar materialeve shkresore, Gjykata konstaton se çështja konkrete nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike ose ligjore, çka mund të justifikonte vonesat apo sjelljen mosvepruese të subjekteve të interesuara, përkatësisht Kapitenerisë së Porteve, Drejtorisë Detare, dhe Zyrës së Përmbarrimit.

ii) Sjellja e kërkuarës

15. Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se vlerësimi i sjelljes dhe i interesit të kërkuarës është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve (*shih vendimet nr. 50, datë 22.11.2011 dhe nr. 14, datë 15.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në çështjen, objekt shqyrtimi, Gjykata vëren se kërkuarësja ka vepruar në përputhje me të drejtat e saj procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion për rivendosjen e së drejtës së cenuar. Nga tërësia e fakteve dhe rrethanave, rezulton se: kërkuarësja, në datën 7.4.2008, ka depozituar pranë Zyrës së Përmbarrimit urdhrin e ekzekutimit dhe kërkesën për zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në datën 9.9.2008, në pritje të veprimeve përmbarrimore, ajo i është drejtuar me kërkesë Drejtorit të Kapitenerisë së Porteve duke e bërë me dije për të drejtën e saj në bazë të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Kërkuarësja i është drejtuar në vijimësi edhe disa institucioneve shtetërore, si: Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit, Ministrisë së Drejtësisë,



Avokatit të Popullit, dhe Kryeministrisë, të cilat kanë rekomanduar marrjen e masave për ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Në datën 16.5.2011 kërkesja ka depozituar në prokurori kallëzim penal ndaj Zyrës së Përmbarrimit për mosmarrjen e masave ligjore për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Nga sa më sipër, në vlerësimin e Gjykatës, nuk rezulton që sjelljet e kërkesës të jenë bërë shkak për moszekutimin e vendimit të formës së prerë, përkundrazi ajo ka qenë aktive në kërkimet e saj për rivendosjen në vend të së drejtës së cenuar.

iii) Sjellja e autoriteteve

17. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata ka theksuar se përballë detyrimit për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të përgjigjen njëjloj (*shih vendimet nr. 7, datë 27.2.2012; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010 dhe nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Mbi bazën e akteve shkresore të administruara, rezulton se Kapiteneria e Porteve ka kundërshtuar veprimet përmbarrimore me anë të padisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, duke kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në lidhje me këtë kërkesëpadi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 1946, datë 25.6.2008, ka vendosur kthimin e akteve pasi adresa e kërkesës, në cilësinë e të paditurës, nuk ka qenë e saktë. Në vijim, Drejtoria Detare, si institucion pasardhës i Kapitenerisë së Porteve, me anë të shkresës nr. 30, prot., datë 11.1.2011, i është përgjigjur Zyrës së Përmbarrimit se “*personi juridik publik, Drejtoria e Përgjithshme Detare, nuk mbart asnjë lloj detyrimi nga ish-personi juridik publik Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve Durrës*”. Pas ankesave të vazhdueshme të kërkesës, Drejtoria Detare, me shkresën nr. 205/3 prot., datë 15.7.2011, ka pranuar njohjen e detyrimeve të ish-Kapitenerisë së Porteve dhe ka shprehur gatishmërinë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor kur të krijohet mundësia brenda strukturës së saj. Nga këto veprime Gjykata konstaton se, nga momenti i nxjerrjes së urdhrin të ekzekutimit (datë 21.1.2008) e deri në pranimin e detyrimit ndaj kërkesës nga Drejtoria Detare (datë 15.7.2011), kanë kaluar 3 vjet e gjysmë.

19. Referuar rikthimit në punë, Drejtoria Detare ka pretenduar pamundësinë objektive për të ekzekutuar vendimin e gjykatës, pasi vendi i mëparshëm i punës së kërkesës (arkëtare-llogaritare) është suprimuar. Për shkak të miratimit të një strukture dhe organike të re, kanë ndryshuar edhe kriteret e punës për pozicionin e ri të specialistes së financës, kriteret të cilat sipas Drejtorisë Detare, kërkesja nuk i përmbush. Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme për këtë rast, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit (*shih vendimet nr. 10, datë 1.3.2012 dhe nr. 2, datë 1.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata vlerëson se autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësinë objektive për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë. Nisur nga ky arsytim, Gjykata çmon se argumentet e paraqitura nga Drejtoria Detare, lidhur me arsyet se përse nuk është ekzekutuar vendimi gjyqësor i formës së prerë, janë të pambështetura.

20. Autoriteti tjetër përgjegjës për ekzekutimin e vendimit, Zyra e Përmbarrimit, fillimisht i është drejtuar debitorit (Drejtorisë Detare) me lajmërim për ekzekutim vullnetar (shkresa me nr. 864 prot., datë 21.4.2008). Në datën 27.12.2010, kjo zyrë, me shkresën nr. 184/10 prot., i ka kërkuar Drejtorisë Detare informacion nëse të drejtat dhe detyrimet e ish-Kapitenerisë së Porteve i janë transferuar Drejtorisë Detare, duke i lënë një afat 10 ditor për kthimin e përgjigjes. Pas përgjigjes së Drejtorisë Detare se ajo nuk mbart asnjë detyrim nga ish-Kapiteneria e Porteve, Zyra e Përmbarrimit nuk ka kryer veprime të mëtejshme përmbarrimore. Pasi kërkesja ka bërë kallëzim penal në prokurori ndaj Zyrës së Përmbarrimit, kjo e fundit, në datën 13.6.2011, me shkresën nr. 09/118 prot., ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit të detyrueshëm ndaj debitorit. Me vendimin nr. 09/118 prot., datë 25.8.2011, Zyra e Përmbarrimit ka vendosur gjobitjen e debitorit, për moskryerjen e veprimit të caktuar, në masën 50.000 lekë. Me shkresën nr. 09/118 prot., datë 3.11.2011, Zyra e Përmbarrimit ka depozituar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës kallëzim penal ndaj Drejtorit të

Përgjithshëm të Drejtorisë Detare, mbi të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Në datën 12.1.2012, me vendimin nr. 09/118 prot., Zyra e Përmbartimit ka lëshuar urdhrin për vendosjen e masës së sekuestros në shpenzimet operative të debitorit, për detyrimin ndaj kërkueses, në masën 936.849 lekë.

21. Në vështrim të fakteve dhe argumenteve të parashtruara, vërehet se kanë kaluar 4 vjet e 10 muaj që nga data kur ka dalë urdhri i ekzekutimit, i cili ende nuk është zbatuar. Në vlerësimin e Gjykatës, autoritetet shtetërore përgjegjëse nuk kanë pasur asnjë pengesë ligjore për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë.

22. Për sa më sipër, Gjykata nuk gjen arsye të bazuara që kanë çuar në mosrealizimin e së drejtës së kërkueses për një proces të rregullt ligjor. Gjykata vlerëson se në çështjen në shqyrtim, Kapiteneria e Porteve dhe më pas Drejtoria Detare i kishin të gjitha mundësitë që të ekzekutonin vendimin gjyqësor të formës së prerë.

23. Si përfundim, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata vlerëson se mosekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë, brenda një afati të arsyeshëm, ka sjellë cenimin e së drejtës së kërkueses për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 297, datë 14.12.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj

VENDIM

Nr. 5, datë 25.2.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Admir Thanza	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“



me sekretare Elta Milori, në datën 23.10.2012 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 27/6 Akti, që i përket:

KËRKUES: Ermir Dervishi, përfaqësuar nga avokat Arian Salati, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimeve nr. 127, datë 26.11.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë; nr. 87, datë 28.03.2002 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 590, datë 25.10.2002 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 31, germa “ç”, 33/1, 42/1, 131/f, 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 1 dhe 48 të ligjit nr. 8577, datë 2.10.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes, Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, që kërkoi pranimin e kërkesës dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 127, datë 26.11.2001, ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit, në mungesë, për kryerjen e veprave penale: të “vrasjes me paramendim”, në bashkëpunim dhe, në bazë të neneve 78, 50/gj dhe 49 të Kodit Penal (KP) e ka dënuar me 20 (njëzet) vjet burgim; të “mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit” dhe, në bazë të neneve 278/2 e 49 të KP-së e ka dënuar me 2 (dy) vjet burgim. Në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55 të KP-së, e ka dënuar përfundimisht me 20 (njëzet) vjet burgim. Në këtë proces gjyqësor, kërkuari është mbrojtur nga mbrojtësi i caktuar kryesisht, i cili ka ushtruar edhe të drejtën e ankimit në Gjykatën e Apelit Durrës dhe rekursin në Gjykatën e Lartë.

2. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 87, datë 28.3.2002, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

3. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 590, datë 25.10.2002, ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi.

4. Në vitin 2006 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka nxjerrë urdhrin nr. 38, datë 18.4.2006 “Për vënien në ekzekutim të vendimit nr. 127, datë 26.11.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë”. Kërkuari është arrestuar në Tiranë, në datën 3.11.2011.

II

5. **Kërkuari** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në datën 30.1.2012 duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve të dhëna nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm gjatë proceseve gjyqësore të zhvilluara në mungesën e tij. Në thelb, kërkuari pretendon cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në aspektet e mëposhtme:

5.1 *Është cenuar e drejta për t'u dëgjuar*, pasi është hetuar e gjykuar në mungesë, si rezultat i mospërmbushjes nga organet shtetërore të detyrimit për vënien në dijeni për procesin gjyqësor në ngarkim të tij, ndërkohë që ai ndodhej jashtë shtetit dhe nuk i fshihej drejtësisë.

5.2 *Është cenuar e drejta e mbrojtjes*, pasi si rezultat i mungesës së njoftimit efektiv për procesin gjyqësor në ngarkim, ai nuk ka pasur mundësi të zgjedhë mbrojtësin me vullnetin e tij të lirë, por është mbrojtur nga mbrojtës i caktuar kryesisht nga autoriteti procedues.

5.3 *Është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi nuk i është dhënë mundësia që të dëgjohen argumentet e tij dhe të ballafaqohet me dëshmitarët e akuzës.

6. **Subjekti i i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme** nuk paraqiti prapësime me shkrim.

III

A. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur, të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit

7. Kërkuesi, në thelb, ka pretenduar se nuk ka marrë dijeni efektivisht mbi procesin gjyqësor në ngarkim të tij si rezultat i mospërmbushjes, nga ana e autoriteteve, të detyrimeve që burojnë nga Kodi i Procedurës Penale (KPP) për njoftimin e të pandehurit që nuk gjendet. Për rrjedhojë, atij i është mohuar e drejta për t'u dëgjuar, e drejta për t'u mbrojtur, barazia e armëve dhe kontradiktoriteti, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

8. Gjykata, bazuar në pretendimet e kërkuesit dhe argumentet mbi të cilat ato mbështeten, vlerëson se këto pretendime duhet të trajtohen në këndvështrim të respektimit të së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.

9. Gjykata rikonfirmon qëndrimin se të informosh dikë për një proces të hapur kundër tij, është një akt gjyqësor i një rëndësie të veçantë që duhet bërë në përputhje me kërkesat procedurale, të cilat garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave nga ana e të pandehurit. E drejta e një personi të akuzuar, për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij, është thelbësore për një proces të drejtë. Kjo përfshin jo vetëm praninë fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte. Shteti ka detyrimin për ta njoftuar të pandehurin në mënyrë efektive dhe të përshtatshme për seancën dhe të marrë masa për të siguruar praninë e tij. Po ashtu, një nga kriteret e gjykimit të drejtë është edhe e drejta e çdokujt, të akuzuar për një vepër penale, për t'u mbrojtur efektivisht nga një mbrojtës ligjor, e drejtë e cila nuk humbet edhe pse personi i akuzuar penalisht nuk ndodhet vetë personalisht në gjyq (*shih vendimin nr. 26, datë 8.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson të nevojshme të risjellë në vëmendje rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës të pasqyruara në rezolutën (75) 11 "Për kriteret e gjykimit në mungesë të të akuzuarit", ku shteteve anëtare u rekomandohen që të mbajnë parasysh nëntë rregulla minimale: i) askush nuk duhet të gjykohej pa pasur një thirrje për gjyq në kohë; ii) kjo thirrje për gjyq duhet të ketë të sanksionuara edhe pasojat nëse i akuzuari nuk vjen në gjykim; iii) kur gjykata vëren se edhe pse i akuzuari është njoftuar dhe nuk është paraqitur, ajo, nëse çmon se prania e tij në proces është e pazëvendësueshme ose beson se i akuzuari është penguar të paraqitet, duhet të vendosë shtyrjen e procesit; iv) i akuzuari nuk duhet të gjykohej në mungesë, nëse është e mundur të transferohen procedimet te një shtet tjetër ose të aplikohet për ekstradim; v) kur i akuzuari gjykohej në mungesë, provat duhet të merren në mënyrë të zakonshme dhe mbrojtja duhet të ketë të drejtë të ndërhyjë; vi) një vendim gjykate, i dhënë në mungesë, duhet t'i njoftohet personit sipas rregullave për njoftimet dhe marrjes dijeni brenda afatit të parashikuar për apelim. Ky afat duhet të fillojë që nga dita e marrjes dijeni efektivisht të personit, përveçse kur ai qëllimisht i fshihet drejtësisë; vii) çdo personi të gjykuar në mungesë duhet t'i jepet e drejta për apelim, me çdo lloj mjeti ligjor që do t'i ishte dhënë sikur ai të ishte i pranishëm; viii) për personin e gjykuar në mungesë, të cilit nuk i është bërë njoftimi në mënyrën e duhur, duhet të ketë një mjet ankimi që t'i mundësojë atij shfuqizimin e vendimit; ix) një person i gjykuar në mungesë, por që njoftimi i është bërë në rregull, duhet të ketë të drejtën e një rigjykimi në mënyrën e zakonshme, nëse ai mund të provojë mungesën e tij para gjykatës për arsye të pavarura nga vullneti i tij.

11. KEDNJ-ja u lë shteteve kontraktuese një diskrecion të gjerë lidhur me zgjedhjet e mjeteve, për të siguruar se sistemi i tyre ligjor është në përputhje me kërkesat e nenit 6 të saj. Veçanërisht, mjetet procedurale të ofruara nga legjislacioni i brendshëm dhe praktika duhet të tregojnë se ato kanë qenë efektive, kur një person i akuzuar penalisht nuk ka hequr dorë nga të drejtat e tij për t'u dëgjuar dhe mbrojtur personalisht dhe as nuk i është fshehur drejtësisë (*shih vendimet nr. 30, datë 17.6.2010; nr. 45, datë 10.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, neni 6 i KEDNJ-së nuk e ndalon një person të heqë dorë nga të drejtat e tij. Por, megjithatë, për qëllimet e



Konventës do të konsiderohet efektive, që të drejtat e atij, që ka hequr dorë prej tyre, të sanksionohen pa ekuivoqe dhe të shoqërohen me një minimum të garancive, për shkak të rëndësisë së tyre (*shih vendimin nr. 26, datë 8.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Lidhur me zbatimin e rregullave procedurale të njoftimit në procesin e dënimit të të gjykuarit në mungesë, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se të informosh dikë se kundër tij ka filluar ndjekja penale është një akt ligjor i një rëndësie të tillë sa duhet përmbushur në përputhje me kërkesat procedurale dhe substanciale, të cilat duhet të garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave të të akuzuarit; marrja dijani jo e plotë dhe në rrugë informale nuk mund të jetë e mjaftueshme. Fakte të ndodhura ose të njohura mund të përbëjnë tregues të padiskutueshëm për gjykatën se i akuzuari ka dijani për ekzistencën e procedimeve penale kundër tij, për natyrën dhe shkakun e akuzës, siç janë rastet kur i akuzuari deklaron publikisht ose me shkrim se ai nuk do t'i përgjigjet thirrjeve për gjyq për të cilat ai ka marrë dijani përmes burimeve të ndryshme dhe jo nga autoritetet, ose kur ai i shpëton një tentative arresti, ose kur materialet që sillen në vëmendje të autoriteteve. Ndërkohë, thjesht mungesa e ankuesit në shtëpi nuk mjafton për të konsideruar se ai kishte dijani për procedurat dhe, për rrjedhojë, largohet (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen "Shkalla kundër Shqipërisë", i datës 10 gusht 2011*).

13. Gjykata rithekson se është detyrë e autoriteteve shtetërore përkatëse që të njoftojnë në mënyrë rigoroze, konform kërkesave procedurale, të pandehurin ndaj të cilit ka filluar një proces penal, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet në përfundimin se i pandehuri ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim. Vërtetimi i këtyre fakteve sipas kësaj Gjykate, për të dyja rastet, është detyrë e organeve kompetente. Dispozitat procedurale për njoftimet vendosin një rend të caktuar për mënyrën e njoftimit të akteve për të pandehurin, prandaj duhet respektuar rendi sipas preferencës ligjore për këtë qëllim. Me këtë detyrim të organeve përkatëse shtetërore, për të njoftuar në mënyrë rigoroze të pandehurin dhe për të provuar se ai i fshihet drejtësisë, është e lidhur e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim, si dhe kompetenca e gjykatës për të vendosur për gjykimin e tij në mungesë kur janë respektuar në mënyrë rigoroze dispozitat për njoftimin (*shih vendimin nr. 30, datë 17.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në vështrim të sa më sipër, rregullat e ndjekura për njoftimin dhe efektiviteti i njoftimit të kërkuesit nga ana e autoriteteve, vlerësohen nga Gjykata në funksion të realizimit të së drejtës së mbrojtjes. Për këtë arsye, Gjykata çmon të vlerësojë nëse autoritetet kompetente kanë përmbushur efektivisht detyrimin për njoftimin e kërkuesit, të gjykuar në mungesë, përmes zbatimit rigoroz të kërkesave procedurale për njoftimin e tij.

15. Nga materialet e administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se Komisariati i Policisë Kavajë, përmes shkresës nr. 1124, datë 11.7.2000, ka informuar Prokurorinë e Rrethit Kavajë se: "*shtetasi Ermir Dervishi është larguar në drejtim të paditur, vazhdon puna për saktësimin e vendndodhjes*". Në po atë datë (11.7.2000), prokurori i çështjes ka paraqitur kërkesë për deklarimin e ikjes së të pandehurve E.Dervishi dhe S.Kazazi, me arsyetimin se: "*nga kërkimet e bëra nga Komisariati i Policisë Kavajë si dhe të policisë gjyqësore ka rezultuar pamundësia e ekzekutimit të këtyre vendimeve, pasi personat janë larguar dhe i janë shmangur hetimit*". Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 66, datë 17.7.2000, ka pranuar kërkesën e Prokurorit dhe ka vendosur deklarimin e ikjes së të pandehurit E.Dervishi, me arsyetimin se: "*organi i prokurorisë, konform rregullave procedurale, ka shpallur kërkimin e këtyre të pandehurve me qëllim që të zbatonte vendimin nr. 57, datë 22.6.2000 për caktimin e masës së sigurimit "arrest me burg" në mungesë, por ka rezultuar se i pandehuri është larguar në drejtim të paditur. Në rrethana të tilla, gjykata çmon se kërkimet për të pandehurit janë bërë të plota dhe, në bazë të nenit 247/2 të KPP-së, të deklarohen të ikur*". Gjykata ka caktuar mbrojtës për secilin të pandehur dhe vendimi ka marrë formë të prerë në datën 27.7.2000. Gjithashtu, rezulton se vendimi "Për njoftimin e akuzës", i datës 24.10.2000, dhe procesverbali "Për përfundimin e hetimeve" i datës 25.10.2000 i janë komunikuar mbrojtësit të të pandehurit, të caktuar kryesisht, i cili i ka nënshkruar aktet pa asnjë vërejtje.

16. Në referim të nenit 247 të KPP-së, kur personi ndaj të cilit është marrë masa nuk gjendet, është e domosdoshme që oficeri ose agjenti i policisë gjyqësore (OPGJ) të mbajë procesverbal, në të cilin tregon kërkimet e bëra, të cilat ia dërgon gjykatës që ka dhënë vendimin. Nëse kjo e fundit çmon se kërkimet janë bërë të plota, atëherë deklaron ikjen e personit. Gjykata vlerëson se vendimi gjyqësor për vazhdimin e gjykimit në mungesë është marrë pa i respektuar kërkesat dhe kriteret ligjore të parashikuara nga KPP-ja. Në mungesë të procesverbalit të mbajtur nga OPGJ-ja, që duhet të tregonte veprimet konkrete të kryera për gjetjen e të pandehurit, në referim të nenit 247, pika 1 e KPP-së, si dhe nisur nga fakti se kërkimet për gjetjen e të pandehurit nuk kishin përfunduar (sipas shkresës së Komisarariatit të Policisë Kavajë), Gjykata arrin në përfundimin se nuk janë respektuar rregullat mbi njoftimin e kërkuesit të deklaruar të ikur me vendim gjyqësor.

17. Gjithashtu, Gjykata konstaton se gjatë procesit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë për njoftimin e kërkuesit ka përpiluar vetëm dy fletëthirrje, akte të cilat gjenden të administruara në dosjen gjyqësore. Të pandehurit i është dërguar, përmes ftuesit, fletëthirrja për seancën e datës 20.11.2000, e cila mban shënimin "*adresë e shkurtër*". Kjo mangësi e fletëthirrjes është vënë në dukje edhe në seancën gjyqësore të asaj date nga prokurori i çështjes, i cili ka kërkuar të përsëritet thirrja e të pandehurit, kërkesë që është pranuar nga gjykata. Fletëthirrja për seancën gjyqësore të datës 23.11.2000, e cila është përpiluar si në emër të të pandehurit ashtu dhe të mbrojtësit të caktuar kryesisht, mban shënimin "*s'ka njeri në shtëpi, ndodhen jashtë shtetit*". Ajo është e nënshkruar nga ftuesi dhe një person tjetër, për të cilin është e pamundur të identifikohet lidhja familjare, gjinore, e krushqisë ose shoqërore me të pandehurin. Seanca gjyqësore e datës 23.11.2000 është zhvilluar vetëm në prani të mbrojtësit të caktuar kryesisht, i cili për shkak të konstatimit të disa mangësive të fashikullit hetimor, i ka kërkuar gjykatës kohë për shqyrtimin e hollësishëm të tyre, kërkesë e cila është pranuar.

18. Në vështrim të standardeve kushtetuese dhe kërkesave procedurale penale lidhur me njoftimin e të pandehurit, kur ai nuk gjendet, si dhe të rrethanave konkrete të çështjes, Gjykata vlerëson se organet shtetërore nuk kanë marrë të gjitha masat dhe nuk kanë kryer të gjitha veprimet e duhura për përmbushjen e detyrimeve ligjore për njoftimin personalisht të kërkuesit. Shkeljet procedurale në drejtim të rregullave të njoftimit të kërkuesit tregojnë mungesën e njoftimit efektiv dhe zyrtar të kërkuesit në gjykimin e zhvilluar nga Gjykata e Rrethit Kavajë dhe nuk provojnë se ai ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim.

19. Për sa i përket shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Durrës, Gjykata konstaton se edhe gjatë këtij procesi gjyqësor janë lejuar shkelje procedurale në lidhje me njoftimin e kërkuesit të gjykuar në mungesë. Për më tepër, vërehet se gjatë këtij procesi gjyqësor nuk janë korrigjuar mangësitë procedurale të gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

20. Gjykata thekson se gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi, si i tërë, ka qenë i rregullt, duke u ndalur në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces. Gjykata ka pranuar cenimin e parimit për një proces të rregullt ligjor në rastet kur gjykata e shkallës më të lartë, duke u bazuar në kompetencat që i jep Kodi i Procedurës, nuk ka plotësuar apo nuk ka korrigjuar mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor.

21. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se njoftimi sipas fletëthirrjeve të datave 24.1.2002 dhe 19.2.2002, për zhvillimin e gjykimit në Gjykatën e Apelit Durrës, mbi ankimin e paraqitur nga mbrojtësi i caktuar kryesisht i kërkuesit të gjykuar në mungesë, është bërë vetëm për mbrojtësin, ndërkohë që nuk gjendet e administruar fletëthirrje për njoftimin e kërkuesit. Gjykata, nisur nga fakti se rregullat procedurale mbi njoftimin e të pandehurit për zhvillimin e procesit gjyqësor në Gjykatën e Apelit janë të njëjta me ato që zbatohen për njoftimin nga gjykata e shkallës së parë, arrin në përfundimin se Gjykata e Apelit nuk ka marrë masat e duhura për njoftimin e të pandehurit.



22. Po ashtu, referuar nenit 425 të KPP-së, që përcakton kufijtë e shqyrtimit të çështjes, Gjykata e Apelit duhet të vlerësonte respektimin e kërkesave për njoftimin e të gjykuarit në mungesë gjatë procesit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe të mos kufizohej vetëm në shkaqet e paraqitura në ankim nga mbrojtësi i caktuar kryesisht. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se Gjykata e Apelit Durrës nuk ka plotësuar dhe as ka korrigjuar mangësitë dhe gabimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë në plotësimin e standardeve mbi njoftimin. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se procesi i zhvilluar në Gjykatën e Apelit Durrës ka cenuar të drejtën e kërkuarit për një proces të rregullt ligjor dhe, si i tillë, vendimi duhet të shfuqizohet.

23. Gjykata vlerëson se shkelja e së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe Gjykatës së Apelit Durrës, nuk është plotësuar ose korrigjuar nga ana e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, arrihet në përfundimin se edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka lejuar një proces të parregullt në aspektin kushtetues dhe, për pasojë, vendimi duhet të shfuqizohet.

24. Në përfundim, Gjykata vlerëson se gjatë procesit të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Lartë, kërkuarit i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të (mos)garantimit të së drejtës së mbrojtjes dhe së drejtës për t'u dëgjuar, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës².
- Shfuqizimin e vendimeve nr. 87, datë 28.3.2002 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr. 590, datë 25.10.2002 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) vetëm në pjesën e urdhërimeve që lidhen me shtetasin Ermir Dervishi.
- Kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit Durrës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Admir Thanza, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha

Anëtarë kundër: Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj

² Gjyqtarët S.Berberi dhe F.Hoxha votuan pro pranimit tërësisht të kërkesës dhe kthimit të çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

VENDIM
Nr. 6, datë 26.2.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	anëtar	i	“	“
Admir Thanza	anëtar	i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	anëtare	e	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 9.10.2012 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.28/7 Akti, që i përket:

KËRKUES: Besnik Braka, përfaqësuar nga avokatët Nexhdet Kambo dhe Bardhyl Ibra, me prokurë; Zamira Gjongecaj, përfaqësuar nga avokat Nexhdet Kambo, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga z.Artur Selmani, me autorizim.

OBJEKTI: -Shfuqizimi, si të papajtvshëm me Kushtetutën, i vendimeve: nr.1, datë 12.1.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr.62, datë 29.2.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë;

-Pezullimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 18, 42, 43, 131/f, 134/g të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 28 dhe 45 të ligjit nr.8577, datë 2.10.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes, Vitore Tusha; përfaqësuesit e kërkuarit që kërkojnë pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, që kërkojnë rrëzimin e kërkesës dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuar Besnik Braka është arrestuar në datën 20.4.2005 me akuzën për kryerjen e veprave penale të “trafikimit të armëve dhe municionit” e kryer në bashkëpunim, të “prodhimit dhe shitjes së narkotikëve” e kryer në bashkëpunim, të “mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, të “falsifikimit të dokumenteve”, të “falsifikimit të akteve të gjendjes civile”, parashikuar respektivisht nga nenet 278/a/2, 283/2, 278/2, 186/1 dhe 191/1 të Kodit Penal (KP). Kurse, kërkuarja Zamira Gjongecaj është arrestuar në datën 21.4.2005 me akuzën për kryerjen e veprës penale të “prodhimit dhe shitjes së narkotikëve” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i KP-së.

2. Gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, pas kthimit të çështjes për rigjykim, mbrojtësi i kërkuarve (i zgjedhur prej tyre me deklaram në seancë) ka depozituar në datën 25.4.2008 kërkesë me shkrim për të proceduar me gjykim të shkurtuar, kërkesë e cila është riparaqitur në seancën gjyqësore të datës 2.5.2008.

3. Në seancën e datës 7.5.2008, prokurori ka kundërshtuar procedimin me gjykim të shkurtuar, me arsyetimin se: “kemi dhe akte të tjera për të paraqitur si prova përpara gjykatës, të



cilat janë procesverbale deklarimesh të dëshmitarëve”, konkretisht 41 procesverbale të marrjes në pyetje të personave që deklarojnë rrethana të hetimit. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin e ndërmjetëm të datës 14.5.2008, ka vendosur mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, duke arsyetuar se çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet. Për pasojë, gjykimi ka vazhduar sipas rregullave të gjykimit të zakonshëm dhe, gjatë shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues ka vendosur, midis të tjerash, edhe marrjen e dy provave të reja: a) procesverbal për paraqitje për njohje i datës 27.6.2005; b) akti i ekspertimit balistik nr.8484, datë 9.12.2008.

4. Në përfundim të procesit gjyqësor, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr.1, datë 12.1.2009, ka vendosur, midis të tjerash: (i) deklarimin fajtores të së pandehurës Z.Gjongecaj për veprën penale të “prodhimit dhe shitjes së narkotikëve” të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal (KP) dhe dënimin e saj me 7 vjet burgim. (ii) deklarimin fajtor të të pandehurit B.Braka për veprën penale të “trafikimit të armëve dhe municionit” të kryer në bashkëpunim, “prodhimit dhe shitjes së narkotikëve” të kryer në bashkëpunim, “mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, “përdorimit të dokumenteve të falsifikuara” dhe pushimin e akuzës për veprën penale të “përdorimit të akteve të gjendjes civile të falsifikuara”, si të amnistuar. Bazuar në nenin 55 të KP-së, ka dënuar të pandehurin me një dënim të vetëm me 14 vjet burgim.

5. Kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, paraqitën ankim si prokurori i çështjes ashtu edhe bashkë të pandehurit nëpërmjet mbrojtësve të tyre. Bashkë me ankimin ndaj vendimit përfundimtar, ata paraqitën ankim edhe ndaj vendimit të ndërmjetëm të mospranimit të gjykimit të shkurtuar.

6. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr.23, datë 14.4.2009, ka vendosur: i) lënien në fuqi të vendimit për të pandehurën lidhur me deklarimin fajtores dhe cilësimin ligjor të veprës penale; ndryshimin e këtij vendimi vetëm për sa i përket masës së dënimit, duke e dënuar atë me 9 vjet burgim. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), zbritjen me 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht të pandehurën me 6 vjet burgim. ii) lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për kërkuesin, lidhur me deklarimin fajtor, cilësimin ligjor të veprës penale dhe dënimin e tij përfundimisht; ndryshimin e këtij vendimi vetëm për sa i përket masës së dënimit, duke e dënuar atë, në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), me 9 vjet e 4 muaj burgim dhe 200.000 lekë gjobë.

7. Gjykata e Lartë, mbi rekursin e paraqitur nga prokurori i Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda, si dhe nga njëri prej bashkë të pandehurve, me vendimin nr.00-2012-338 (62), datë 29.2.2012, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 23, datë 14.4.2009 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe lënien në fuqi të vendimit nr.1, datë 12.1.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

8. Në datën 9.5.2012, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka nxjerrë, veçmas për secilin kërkues, urdhrin “Për ekzekutimin e vendimit penal nr.1, datë 12.9.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për të dënuarit Zamira Gjongecaj dhe Besnik Braka”, nga përmbajtja e të cilit rezulton se Z.Gjongecaj është liruar në datën 29.4.2009, pasi ka plotësuar kohën e dënimit 2196 ditë burgim, por duhet të arrestohet sepse i kanë mbetur edhe 360 ditë të tjera, kurse B.Braka është liruar në datën 30.12.2011, pasi ka plotësuar kohën e dënimit 1940 ditë burgim, por duhet të arrestohet sepse i kanë mbetur edhe 1940 ditë.

II

9. **Kërkuesit** i janë drejtuar veçmas Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve nr. 01, datë 12.1.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr.62, datë 29.2.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, për arsye se këto vendime u kanë cenuar atyre të drejtat kushtetuese të sanksionuara në nenet 4, 17, 18, 42 dhe 43 të Kushtetutës. Në thelb, kërkuesit pretendojnë cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në aspektet e mëposhtme:

9.1 Rrëzimi i kërkesës për gjykim të shkurtuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda është joracional, i pajustificuar me zgjidhjen e ndonjë situatë të paqartë dhe dëmtues i interesave të të pandehurve. Gjatë gjykimit të çështjes nuk doli asnjë provë e re për t'u shqyrtuar.

9.2 Është cenuar e drejta e ankimit ndaj vendimit në një gjykatë më të lartë dhe e drejta e aksesit, pasi Gjykata e Lartë, duke e prishur vendimin e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda që në zbatim të nenit 406/1 të KPP-së ka zbritur dënimin me 1/3, e bën të pakontrollueshëm vendimin për mospranimin e gjykimit të shkurtuar.

9.3 Është cenuar e drejta e mbrojtjes efektive, barazia e armëve dhe kontradiktoriteti në Gjykatën e Lartë, pasi kërkuesit nuk janë njoftuar për gjykimin e çështjes dhe, për rrjedhojë, janë përfaqësuar nga një mbrojtës i caktuar kryesisht, i cili nuk ka kërkuar njohjen me materialet e çështjes.

9.4 Është cenuar parimi i paanshmërisë, pasi gjykatat kanë mbajtur qëndrime të qarta subjektive në favor të akuzës.

9.5 Është cenuar e drejta e kërkuesve për një gjykim publik dhe brenda një afati të arsyeshëm, pasi janë dashur 8 vjet për gjykimin e çështjes.

9.6 Është cenuar parimi i shtetit të së drejtës, pasi gjykatat kanë vendosur tej diskrecionit të njohur nga Kushtetuta.

9.7 Janë kufizuar të drejtat individuale në kundërshtim me ligjin, pa asnjë interes publik dhe në mënyrë disproporcionale, duke dhunuar thelbin e së drejtës.

10. Gjykata, në mbështetje të nenit 1 pika 2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", në lidhje me nenin 92 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), meqenëse kërkuesit janë gjykuar në të njëjtin proces gjyqësor dhe kundërshtojnë të njëjtat vendime, vendosi bashkimin e kërkesave dhe shqyrtimin e tyre në një çështje të vetme.

11. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, prapësoi si vijon:

11.1 Pretendimi i kërkuesve për cenimin e të drejtës së ankimit është i pabazuar, pasi nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se atyre u është dhënë mundësia e paraqitjes së çdo lloj ankimi si ndaj vendimit të ndërmjetëm të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për mospranimin e gjykimit të shkurtuar, ashtu edhe ndaj vendimeve përfundimtare të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe të Gjykatës së Lartë.

11.2 Zgjidhja në themel e çështjes nga Gjykata e Lartë është e bazuar, pasi, bazuar në dispozitat e KPP-së për gjykimin e shkurtuar dhe kuptimit të këtij instituti, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka zbatuar gabim ligjin procedural penal për sa i përket aplikimit të gjykimit të shkurtuar gjatë gjykimit në shkallë të dytë, sipas rregullimeve që përcaktohen në nenin 404 të KPP-së.

11.3 Po ashtu, i pabazuar është edhe pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të barazisë së armëve në gjykim për shkak të mosnjoftimit për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për faktin se mbrojtësi i kërkuesve ka marrë dijeni për depozitimin e rekursit dhe ka firmosur në emër të kërkuesve. Bazuar në nenin 436 të KPP-së, si dhe në praktikën e konsoliduar të Gjykatës së Lartë për njoftimet e palëve për të marrë pjesë në gjykim, njoftimi i rekursit avokatit dhe afishimi publik i listave të gjykimit ka vlerën e njoftimit të rregullt. Për më tepër, Gjykata e Lartë, në kushtet kur rekursi paraqitej nga prokurori, çka mund të sillte rëndimin e pozitës të të gjykuarve, në mungesë të kërkuesve dhe të mbrojtësve të zgjedhur prej tyre, u ka caktuar atyre mbrojtës kryesisht dhe ka vendosur shtyrjen e procesit gjyqësor me 15 ditë.



III

A. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës së ankimit në një gjykatë më të lartë dhe të drejtës së aksesit

12. Kërkuesit kanë pretenduar se lënia në fuqi e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë dhe prishja e vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, që ka vendosur zbritjen e dënimit të kërkuesve me 1/3, u ka mohuar atyre të drejtën e ankimit ndaj një vendimi gjyqësor të padrejtë në gjykatën më të lartë, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës.

13. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) e ka vlerësuar të drejtën e ankimit ndaj një vendimi gjyqësor, të lidhur me të drejtën e aksesit, si pjesë të pandara dhe garanci të procesit të rregullt gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Sipas jurisprudencës së konsoliduar të kësaj Gjykate, e drejta e ankimit duhet kuptuar si mundësi e çdo individit për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj (*shih vendimin nr. 14, datë 26.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata ka pohuar, gjithashtu, se e drejta e ankimit, e sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës, është një e drejtë procedurale që shërben për të mbrojtur një të drejtë substanciale. Në këtë kuptim, në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit, ka rëndësi të realizohet si aspekti formal/procedural, ashtu edhe ai substancial. Kërkesat procedurale të ankimit janë, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë të pandehurit për të ushtruar efektivisht ankimin ndaj vendimit gjyqësor. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale penale është pjesë e të drejtës së të pandehurit për të pasur akses në gjykatë. Aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Mohimi i të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 4, datë 23.2.2011; nr.14, datë 3.6.2009 dhe nr.7, datë 11.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në funksion të garantimit të së drejtës për t'u ankuar ndaj një vendimi gjyqësor penal, neni 43 i Kushtetutës vihet në zbatim përmes parashikimeve të neneve 407-421 të Kodit të Procedurës Penale që disiplinojnë ushtrimin e ankimit. Mbi bazën e këtyre dispozitave, është ligji ai që cakton rastet në të cilat vendimet e gjykatës mund të ankimohen, si dhe mjetin e përshtatshëm ankimues, që mund të jetë apeli, rekursi në Gjykatën e Lartë ose kërkesa për rishikim, duke parashikuar aspektet formale dhe afatet procedurale për ushtrimin e këtyre mjeteve ankimuese (*shih vendimin nr.14, datë 26.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në rastin konkret Gjykata, duke konstatuar se argumentet e kërkuesve në mbështetje të pretendimit të cenimit të së drejtës së ankimit dhe aksesit në gjykatë kanë të bëjnë me mohimin e mundësisë për të ankimuar vendimin për mospranimin e gjykimit të shkurtuar, vlerëson të risjellë në vëmendje karakteristikat e gjykimit të shkurtuar, i cili hyn në kategorinë e gjykimeve të posaçme. Neni 404 i KPP-së disponon se gjykata e shqyrton kërkesën për gjykim të shkurtuar përpara se të fillojë shqyrtimi gjyqësor dhe kur çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, vendos të pranojë gjykimin e shkurtuar. Në të kundërt, ajo e refuzon kërkesën dhe vazhdon me gjykim të zakonshëm. Vendimi i gjykatës, si në rastin kur pranon gjykimin e shkurtuar ashtu edhe kur e refuzon atë, është një vendim i ndërmjetëm. Kur i pandehuri ka bërë kërkesë që të procedohet me këtë lloj gjykimi, nëse gjykata e zakonshme çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, pa iu nënshtruar provat debatit gjyqësor dhe pa marrë prova të reja, vlerësim i cili konsiston në bindjen e brendshme të gjyqtarit, vendos gjykimin e shkurtuar. Pra, gjykimi i shkurtuar nuk realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit, i cili nëse ka dyshime mbi këtë vlerësim, kjo mjafton që gjyqtari të rrëzojë kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të posaçëm dhe të vazhdojë gjykimin me procedurën e zakonshme, duke respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor (*shih vendimet nr.4, datë 10.2.2012*

dhe nr.14, datë 26.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese). Po ashtu, sipas vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.2, datë 29.01.2003, gjykimi i shkurtuar ka vlerë për ekonomi gjyqësore, sepse thjeshton dhe shkurton procedurat, rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e gjykimit dhe sjell si pasojë një përfitim për të pandehurin në uljen në 1/3 e masës së dënimit dhe mosaplikimin e dënimit me burgim të përjetshëm. Ky përfitim nuk duhet kurrsesi të shkojë në dëm të dhënies së drejtësisë.

17. Duke iu referuar çështjes konkrete, rezulton se kërkuesit e kanë realizuar efektivisht në apel të drejtën e ankimit ndaj vendimit të ndërmjetëm të mospranimit të gjykimit të shkurtuar si në aspektin procedural ashtu edhe substancial, pasi ky lloj ankimi i paraqitur prej tyre është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, së bashku me ankimin ndaj vendimit përfundimtar. Kërkuesit, në kuptimin kushtetues, kanë pasur akses të plotë në gjykatë, në të gjitha shkallët e gjykimit. Ata jo vetëm kanë realizuar të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje përfundimtare, përderisa ankimi i paraqitur është shqyrtuar dhe konsideruar jo vetëm nga Gjykata e Apelit, por edhe nga Gjykata e Lartë. Çështja që i përket kërkuesve është dëgjuar publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj, në rastin konkret, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Vendimi është ankimuar nga kërkuesit në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, e cila ka vendosur uljen e dënimit me 1/3 për secilin nga kërkuesit, duke zbatuar, në këtë mënyrë, përfitimet që burojnë nga procedimi me gjykim të shkurtuar.

18. Nga ana tjetër, Gjykata konstaton se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke e vlerësuar vendimin e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda të marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural, arsyeton se: *“në rast se gjatë gjykimit janë marrë prova të reja apo shqyrtimi i provave të fashikullit është i rëndësishëm për cilësimin ligjor të fakteve, gjykata ka të drejtën e refuzimit të gjykimit të shkurtuar. Ndërsa në rast se shqyrtimi i provave nuk i ka sjellë ndonjë të re procesit dhe humbjes së të drejtës për të përfutur uljen e 1/3 së dënimit në rast se do ishte pranuar kërkesa për gjykim të shkurtuar, gjykata e apelit duhet të aplikojë nenin 406/1 të KPP-së, pavarësisht se kërkesa për gjykim të shkurtuar në shkallë të parë është rrëzuar, duke ndrequr kështu pasojat e një vendimi të marrë në kundërshtim me ligjin”*.

19. Po ashtu, konstatohet se Kolegji Penal e ka vlerësuar si të bazuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për domosdoshmërinë e marrjes së një prove të re, konkretisht, kryerjen e aktit të ekspertimit tekniko-balistik të fishekëve, akt ky që është kërkuar edhe nga mbrojtësit e kërkuesve në seancën gjyqësore të datës 24.11.2008, në funksion të qartësisimit dhe zbatimit të legjislacionit në fushën e armatimeve.

20. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se argumentet mbi të cilat kërkuesit mbështesin pretendimin për cenimin e të drejtave kushtetuese kanë të bëjnë me çështje të interpretimit e të zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë dhe çmuarjen e provave për të krijuar bindjen e brendshme për zgjidhjen e çështjes konkrete tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Si të tilla, ato përbëjnë çështje që i takojnë sferës së kompetencës të gjykatave të zakonshme për interpretimin e dispozitave ligjore dhe vlerësimin juridik të rrethanave dhe provave të parashtruara nga palët dhe jo juridiksionit kushtetues, i cili nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor dhe, aq më tepër, të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete.

21. Për sa kohë Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ashtu dhe Gjykata e Lartë e kanë marrë çështjen në shqyrtim dhe janë shprehur, me vendim të arsyetuar, mbi pretendimet e parashtruara nga palët, si dhe nisur nga fakti se e drejta e ankimit nuk presupozon që gjykata duhet të pranojë kërkimet e palëve në çdo rast, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimet e kërkuesve për cenimin e të drejtës së ankimit dhe aksesit janë të papazuara.



B. Në lidhje me pretendimin për cenimin e të drejtës së mbrojtjes efektive, barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në Gjykatën e Lartë

22. Kërkesit kanë pretenduar se nuk janë njoftuar për gjykimin e çështjes, për rrjedhojë, janë përfaqësuar nga mbrojtësi i caktuar kryesisht që nuk ka pasur dijeni për çështjen dhe as ka kërkuar njohjen me materialet. Mbrojtësi i caktuar kryesisht nuk u ka garantuar të drejtën e mbrojtjes efektive, barazinë e armëve dhe kontradiktoritetin gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë.

23. Gjykata ka theksuar se veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe, lidhur ngushtë me këto, mbrojtja e të pandehurit, përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj, për respektimin e këtyre parimeve, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, mes të cilave rëndësi të veçantë paraqet, sipas rastit, edhe njoftimi i të pandehurit apo mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes, etj. Synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata, me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij. Është detyrë e shtetit që të marrë masat e duhura për të garantuar pjesëmarrjen në procesin penal të personit të akuzuar ose mbrojtësit ligjor, qoftë edhe atij të caktuar kryesisht (*shih vendimin 18, datë 2.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në lidhje me gjykimin në Gjykatën e Lartë, është vlerësuar se situata juridike kur rekursi paraqitet nga i akuzuari, nuk është e njëllajtë me rastin kur rekursi paraqitet nga prokurori. Në këto raste, Gjykata e Lartë nuk ka ndonjë pengesë për të vazhduar shqyrtimin e çështjes edhe në mungesë, pa shkaqe të arsyeshme, të avokatit të palës së akuzuar, për shkak se argumentet ligjore ai i ka depozituar me shkrim në rekursin e paraqitur përpara saj. Ndryshe paraqitet situata kur, si rrjedhojë e një rekursi të paraqitur nga prokurori, që mbart në potencë mundësinë e përkeqësimit të pozitës së të pandehurit, gjykimi të zhvillohej pa praninë e të gjykuarit ose të avokatit të tij. Në këtë rast, nëse as avokati dhe as i pandehuri nuk paraqiten në seancë në Gjykatën e Lartë, është e palejueshme që ajo të vazhdojë. Në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, për Gjykatën e Lartë del e domosdoshme marrja e masave në mënyrë që të mos lejojë zhvillimin e seancës në mungesë të përfaqësuesit të interesave të të pandehurit, pasi kjo është e vetmja mënyrë që i pandehuri, përmes figurës përfaqësuese të avokatit, të marrë pjesë në debatet e mundshme (*shih vendimet nr.23, datë 13.10.2005; nr.24, datë 26.10.2005; nr.5, datë 4.2.2008; nr.13, datë 21.7.2008; nr.16, datë 15.6.2009; nr.28, datë 2.10.2009; nr.30, datë 26.11.2009; nr.37, datë 24.12.2010; nr.40, datë 22.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se rekursi i paraqitur nga prokurori i është dërguar në datën 7.5.2009 vetëm mbrojtësit të zgjedhur nga kërkesit me deklaram gjatë procesit gjyqësor në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda. Në seancën gjyqësore të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, në datën 1.2.2012, mbrojtësi i kërkesve nuk ka qenë i pranishëm dhe nuk ka paraqitur ndonjë shkak të arsyeshëm për mungesën. Sipas procesverbalit të kësaj seance rezulton se ai ka pasur dijeni rregullisht nga shpallja e datës 24.1.2012. Në këto kushte, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur të shtyjë me 15 ditë seancën gjyqësore duke u caktuar mbrojtës kryesisht të gjykuarve, përfshi edhe kërkesit. Seanca e datës 15.2.2012 është zhvilluar në prani të mbrojtësit të caktuar kryesisht.

26. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në përmbushje të interesave të drejtësisë për realizimin detyrimisht të mbrojtjes, qoftë edhe me avokat të caktuar kryesisht, së të pandehurit që gjykohet në një proces gjyqësor të vënë në lëvizje mbi rekursin e paraqitur nga prokurori, ka marrë masat e domosdoshme duke i caktuar kërkesve një mbrojtës kryesisht dhe duke mos lejuar zhvillimin e seancës në mungesë të avokatit të zgjedhur nga

të pandehurit.

27. Gjykata çmon se argumentet e parashtruara nga kërkuesit për cenimin e mbrojtjes efektive, të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit nuk janë ngritur në nivel kushtetues dhe, për rrjedhojë, janë të pabazuara.

C. Në lidhje me pretendimet e tjera

28. Kërkuesit kanë pretenduar, gjithashtu, se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vendosur përtej diskrecionit të njohur nga Kushtetuta, ka cenuar parimin e paanshmërisë me veprime të qarta subjektive në favor të organit të akuzës dhe se kufizimi i të drejtës për t'u ankuar, nga Gjykata e Lartë, është bërë pa asnjë interes publik dhe në mënyrë disproporcionale.

29. Gjykata, nisur nga natyra e pretendimeve, ripohon qëndrimin e saj të konsoliduar se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material është atribut i gjykatave të zakonshme. Për sa kohë, argumentet në mbështetje të pretendimeve të kërkuesve nuk janë ngritur në nivel kushtetues, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimet e mësipërme janë haptazi të pabazuara.

30. Në përfundim, Gjykata vlerëson se procesi gjyqësor penal i zhvilluar në ngarkim të kërkuesve nuk ka cenuar ndonjë nga elementet e procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar)

MENDIM PAKICE

1. Për këtë çështje, jam i mendimit se duhej pranuar kërkesa *pjesërisht*, vetëm për shfuqizimin e vendimit nr.62, datë 29.2.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, sepse është cenuar e drejta e kërkuesve për një mbrojtës të zgjedhur prej tyre personalisht si dhe për një mbrojtje efektive, si standarde të procesit të rregullt ligjor.

2. Sipas fakteve të çështjes, rezulton se, duke qenë se mbrojtësi i kërkuesve, i zgjedhur me deklaram prej tyre në Gjykatën e Apelit, nuk ka qenë i pranishëm në datën e seancës gjyqësore, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur të shtyjë seancën me 15 ditë si dhe t'i caktojë mbrojtës kryesisht kërkuesve. Në këtë rast, shumica ka vlerësuar se caktimi i mbrojtësit kryesisht, duke mos u lejuar, nga Kolegji Penal, zhvillimi i seancës në mungesë të avokatit të zgjedhur nga të pandehurit, u ka garantuar kërkuesve të drejtën për mbrojtje, edhe nga pikëpamja e mbrojtjes efektive (*prg.25-26 i vendimit*).

3. Neni 31/a, ç dhe neni 33 i Kushtetutës përkatësisht përcaktojnë se: “Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë: a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet për të drejtat e tij, si dhe (...); ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij”



(...) si dhe “Kushdo ka të drejtë të dëgjohej para se të gjykohej. Nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë”. Këto garanci kushtetuese kanë gjetur pasqyrim në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Në nenin 414 të KPP-së parashikohet se akti i ankimit u njoftohet prokurorit, të pandehurit dhe palëve private nga sekretaria e gjykatës që ka dhënë vendimin.

4. Në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese, nisur edhe nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, ka theksuar se e drejta për të marrë pjesë në gjykim e të pandehurit dhe e drejta e tij për të zgjedhur përfaqësuesit ligjorë, është një e drejtë kushtetuese personale (...). E drejta e një personi të akuzuar, për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij, është thelbësore për një proces të drejtë. Kjo përfshin jo vetëm prezencën fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte (...). Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur procedimet janë kontradiktore në natyrë. Shteti ka detyrimin për t'i dhënë të pandehurit një njoftim efektiv dhe të përshtatshëm për seancën dhe të marrë hapa për të siguruar praninë e tij (*shih vendimin nr.30, datë 17.6.2010, të Gjykatës Kushtetuese, prg.28-31*).

5. Ndërsa në lidhje me standardin e mbrojtjes efektive, GJEDNJ-ja ka theksuar se: “..Nisur nga natyra e profesionit të mbrojtësit, si profesion i pavarur nga shteti, mbrojtja e një çështjeje është thelbësisht një marrëdhënie mes mbrojtësit dhe të akuzuarit, pavarësisht faktit se mbrojtësi është i caktuar personalisht nga i pandehuri apo kryesisht dhe si e tillë, përveç se në rrethana të veçanta, nuk mund të jetë përgjegjësi e shtetit sipas Konventës. Autoritetet kombëtare duhet të ndërhyjnë, sipas nenit 6 § 3 (c) të Konventës, vetëm nëse, *haptazi* ose *mjaftueshëm* shfaqet një dështim nga ana e mbrojtësit për të siguruar mbrojtje efektive. Varet nga rrethanat e çështjes nëse autoritetet kompetente duhet të marrin masa dhe nëse, duke vlerësuar procesin si të tërë, përfaqësimi ligjor mund të konsiderohet si “praktik dhe efektiv”. Duke caktuar një mbrojtës për të përfaqësuar një palë në proces, në vetvete nuk siguron efektivitetin e asistencës ligjore” (*Andreyev kundër Estonisë, vendim i datës 22.02.2012; prg.65*).

6. GJEDNJ ka konstatuar shkelje të së drejtës për mbrojtje efektive, në një çështje lidhur me pamjaftueshmërinë e kohës së lënë për mbrojtje mbrojtësit nga gjykata, duke u shprehur konkretisht se: “...pika e nisjes duhet të jetë se në lidhje me përgatitjen e çështjes nga mbrojtësit e caktuar zyrtarisht, rezultati i kërkuar nga neni 6/3 i Konventës nuk është arritur. Gjykata sqaron se mbrojtësi i parë i caktuar, para se të raportonte arsyen e sëmundjes, nuk kishte ndërmarrë asnjë hap si mbrojtës i z.Daud. Ndërsa mbrojtësi i dytë, i caktuar vetëm 3 ditë para se të fillonin procedurat e gjykimit, nuk kishte kohën që i duhej për studimin e dosjes, vizitat tek klienti nëse do ta çmonte të nevojshme dhe përgatitjen e mbrojtjes. Koha mes njoftimit për zëvendësimin e mbrojtësit dhe datës së gjykimit ishte shumë e shkurtër për një çështje komplekse dhe serioze ...” (*Daud kundër Portugalisë, vendim i datës 21 prill 1998, prg.39*).

7. Nga shqyrtimi i dosjes rezultoi se rekursi i paraqitur nga prokurori i është komunikuar në datën 7.5.2009 vetëm *mbrojtësit të zgjedhur me deklaram* gjatë procesit gjyqësor në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda. Në seancën e datës 1.2.2012, mbrojtësi i kërkuesve nuk është paraqitur, por sipas procesverbalit të kësaj seance rezultoi se ka pasur dijeni rregullisht, nga shpallja e datës 24.1.2012. Nga urdhri i Prokurorisë për ekzekutimin e vendimit penal nr.1, datë 12.9.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda për të dënuarit Zamira Gjonceaj dhe Besnik Braka, rezultoi se kërkuesit po gjykohejshin në gjendje të lirë.

8. Në këto rrethana, mendoj se të drejtat e natyrës procedurale të kërkuesve duhet të interpretohen në mënyrë sa më efektive. Sipas nenit 49/1 të KPP-së, i pandehuri që nuk ka zgjedhur mbrojtës ose që ka mbetur pa të, ndihmohet nga një mbrojtës i caktuar nga organi që procedon, në qoftë se e kërkon atë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, para se të caktonte mbrojtës kryesisht, duhej t'i njoftonte ata personalisht që kishin mbetur pa mbrojtje dhe t'u jepte mundësinë që sipas nenit 49/1 të KPP-së, të zgjidhnin mbrojtësin e tyre. Për më tepër që ekzistonte mundësia e përkeqësimit të pozitës, duke qenë se rekursi ishte bërë nga prokurori. Mbrojtësi i zgjedhur me

deklarim nga kërkuesit, për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, nuk nënkupton se ishte zgjedhur i tillë edhe për mbrojtjen pranë Gjykatës së Lartë, prandaj dhe kjo gjykatë, për sa kohë që nuk ka pasur prokurë nga kërkuesit për komunikim me mbrojtës të caktuar prej tyre personalisht për mbrojtje para Gjykatës së Lartë, nuk mund të konsideronte mbrojtësin e zgjedhur me deklarim gjatë procesit gjyqësor në apel si mbrojtës të zgjedhur nga kërkuesit.

9. Përveç sa më lart, nga dosja gjyqësore rezulton se mbrojtësi i caktuar kryesisht (i njëjti mbrojtës për të dy kërkuesit), ka qenë i pranishëm në seancën e datës 15.2.2012, nuk ka paraqitur pretendime me shkrim mbi mbrojtjen dhe është shprehur për lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda vetëm për kërkuesin B.B. Në përfundim të procesit, Gjykata e Lartë ka pranuar rekursin e paraqitur nga prokurori dhe ka vendosur prishjen e vendimit nr.23, datë 14.4.2009 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda që e dënonte kërkuesen Z.GJ. me 6 vjet burgim, ndërsa kërkuesin B.B. me 9 vjet e 4 muaj burg dhe 200.000 lekë gjobë, dhe lënien në fuqi të vendimit nr.1, datë 12.1.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, që parashikonte një masë dënimi 7 vjet burg për kërkuesen dhe 14 vjet burg për kërkuesin, duke iu rënduar pozitën të pandehurve.

10. Në këndvështrim të standardeve të sipërpërmendura të mbrojtjes efektive, për më tepër kur të pandehurve u është rënduar dhe pozita (*reformatio in peius*), mendoj se kërkuesve u është cenuar e drejta e mbrojtjes efektive nga procesi gjyqësor i zhvilluar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

Bashkim Dedja (kryetar)

VENDIM

Nr. 7, datë 27.2.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Admir Thanza	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 9.10.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, çështjen nr. 23,32/5 Akti, që i përket:

KËRKUES: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë;

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, përfaqësuar nga Drejtoresha Ekzekutive, Prof. Av. Aurela Anastasi.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Shqipërisë, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj dhe Arjeta Çefa, me autorizim;

Ministria e Drejtësisë, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim;

Ministria e Financave, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.

OBJEKTI: -Kontrolli i kushtetutshmërisë së nenit 11/2, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, *i ndryshuar*;

- Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë nr. 991/3, datë 2.3.2010 “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 13, datë 12.2.2009, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës



gjqësore, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë, Noterisë dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”;

- Interpretimi përfundimtar i nenit 155 të Kushtetutës, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, *i ndryshuar*, mbi bazën e parimit të aftësisë paguese.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 18, 42, 54/1, 59/1 shkronja “e”, 118, 122, 124/1, 134/1 shkronja “d”, 145/2 dhe 155 të Kushtetutës; neni 6 i KEDNJ-së; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile e Politike.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberin, përfaqësuesen e kërkuarit, që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Hyrja në fuqi e ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare” (në vijim “ligji nr. 9975/2008”) shfuqizoi ligjin “Për sistemin e taksave në RSH” të vitit 2002, i cili parashikonte ndër të tjera, edhe taksat mbi aktet gjyqësore. Sipas nenit 11/2 të ligjit nr. 9975/2008, *të ndryshuar*³, nivelet minimale të tarifave për veprime e shërbime të administratës gjyqësore përcaktohen me anë të udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe institucioneve përkatëse.

2. Udhëzimi nr. 13, datë 12.2.2009 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë, Noterisë dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, (në vijim “udhëzimi nr. 13/2009”), i nxjerrë për këtë qëllim, në pikën 5, parashikon se termi “tarifë” ka të njëjtin kuptim me termin “taksë mbi aktet”, i përdorur në nenin 156 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Në datën 2.3.2010, Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë kanë nxjerrë udhëzimin nr. 991/3, “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 13/2009” (në vijim “udhëzimi nr. 991/3-2010”), ku janë përcaktuar në terma konkretë vlerat e tarifave përkatëse të shërbimit.

3. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec (gjykata referuese), është paraqitur për gjykim çështja me objekt “Shpërblim i dëmit të shkaktuar”. Paditësja D.N. ka kërkuar nga bashkia Pogradec, në cilësinë e të paditurës, shpërblimin me pagën e dy muajve të plotë për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës me afat të caktuar, pagimin e 3 muajve të plotë për mosrespektim të afateve të njoftimit për zgjidhjen e kontratës, si dhe shpërblimin me pagën e një viti pune të plotë për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës pa shkaqe të justifikuara. Meqenëse vlera e objektit të padisë (400 000 lekë), i kalonte 100 000 lekë, pala e paditur, Bashkia Pogradec, kërkoi përpara gjykatës, që në kërkesat paraprake, parapagimin e taksës gjyqësore mbi aktet në masën 3% të vlerës së objektit të padisë. Këtë kërkesë pala e paditur e ka mbështetur në nenet 154, 154/a të Kodit të Procedurës Civile, udhëzimin nr. 991/3-2010, si dhe nenin 11 të ligjit nr. 9975/2008, *të ndryshuar*.

4. Paditësja ka pretenduar pamundësinë financiare për të parapaguar këtë taksë, pamundësi të cilën ajo e ka provuar para gjykatës me anë të disa akteve (certifikatë familjare, vërtetim i Zyrës Vendore të Punësimit, vërtetim i ZVRPP-së Pogradec, vërtetim i Bashkisë Pogradec, etj). Gjykata referuese ka konstatuar se ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e kërkesës paraprake, që ka të bëjë me masën e taksës gjyqësore, përbëhet nga: nenet 102-110 të KPC-së; neni 11 i ligjit nr. 9975/2008 dhe

³ Ndryshuar me ligjin nr. 10065, datë 29.9.2009 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”

udhëzimi nr. 991/3-2010. Mbi bazën e këtyre akteve juridike, në kushtet e një padie të rrjedhur nga një marrëdhënie kontraktore, me vlerë që i kalon 100 000 lekë, është i detyrueshëm parapagimi i tarifës gjyqësore në masën 3% të vlerës së padisë, nga pagimi i së cilës ligji nuk përjashton asnjë kategori personash. Parapagimi i tarifës gjyqësore është kusht i detyrueshëm për vazhdimin e gjykimit; në rast të kundërt, gjykata i kthen aktet pa kryer veprime (neni 154/a dhe 156 i KPC-së).

5. Në këto kushte, gjykata referuese ka vlerësuar se ndodhet përpara një situatë procedurale që pengon vazhdimin e gjykimit, për arsye se paditësja, në bazë të kuadrit ligjor në fuqi është e detyruar të parapaguajë tarifën gjyqësore prej 3% të vlerës së padisë, shumë të cilën ajo nuk ka mundësi financiare për ta paguar. Pasi ka analizuar tërësinë e përmbajtjes së akteve ligjore, që përcaktojnë detyrimin e pagimit të tarifës gjyqësore, dhe ka konkluduar se disa dispozita ligjore specifike të këtyre akteve paraqesin probleme kushtetutshmërie, gjykata referuese ka pezulluar gjykimin e themelit dhe i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata).

6. Një rast analog me objekt “shpërblim dëmi” është paraqitur edhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (gjykata referuese), e cila për të njëjtat arsye e ka pezulluar gjykimin dhe i është drejtuar Gjykatës.

7. *Gjykatat referuese kanë pretenduar se neni 11/2 i ligjit nr. 9975/2008, i ndryshuar dhe udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë nr. 991/3-2010, nuk janë në pajtim me Kushtetutën dhe në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar këto argumente:*

7.1 Aktet ligjore konkrete shfaqin probleme antikushtetutshmërie në drejtim të cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi e kushtëzojnë aksesin me parapagimin e plotë (100%) të tarifës gjyqësore në masën 3% të vlerës së objektit të padisë dhe nuk parashikojnë përjashtime në rastet e pamundësisë financiare për bërjen e kësaj pagese;

7.2 Ky kufizim i së drejtës së aksesit është *jo proporcional* dhe njëkohësisht *diskriminues*, në tejkallim të kriterëve të përcaktuara nga nenet 17 dhe 18 të Kushtetutës;

7.3 Është shkelur rezerva ligjore absolute, e parashikuar në nenin 155 të Kushtetutës, në lidhje me caktimin e taksave, tatimeve dhe detyrimeve financiare vetëm me ligj;

7.4 Neni 11/2 i ligjit nr. 9975/2008, *i ndryshuar*, si dispozitë deleguese, përveç përcaktimit të organit kompetent për nxjerrjen e udhëzimit, nuk plotëson detyrimet e tjera kushtetuese të parashikuara në nenin 118 të Kushtetutës për nxjerrjen e akteve nënligjore;

7.5 Aktet ligjore, objekt shqyrtimi, nuk janë në përputhje me KEDNJ-në dhe të drejtën e Bashkimit Evropian, të cilat garantojnë një proces të rregullt ligjor dhe, në këtë kontekst, edhe të drejtën e aksesit në gjykatë.

8. *Kërkuesi, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNLQ) ka parashtruar këto argumente:*

8.1 Udhëzimi nr. 991/3-2010 nuk është në pajtim me nenin 18 të Kushtetutës. Ky udhëzim, duke vendosur tarifa të barabarta për të gjithë, krijon *diskriminim* të drejtpërdrejtë, thelbësor, për shkak të gjendjes ekonomike, arsimore dhe sociale, si dhe mund të krijojë gjithashtu edhe diskriminim të tërthortë për shkak të gjinisë, moshës apo aftësisë së kufizuar;

8.2 Vendosja e tarifave gjyqësore të papërbalueshme për një shtresë të caktuar të popullsisë krijon barriera të paarsyeshme që *cenojnë të drejtën kushtetuese për akses në gjykatë*, në kuadrin e procesit të rregullt ligjor. Udhëzimi, objekt shqyrtimi, nuk është hartuar në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe të garancisë së thelbit të së drejtës për akses në gjykatë;

8.3 Shteti nuk ka përmbushur detyrimin e tij për mbrojtjen e veçantë që duhet t’u ofrojë personave në nevojë, të përcaktuar në nenet 54 e 59 të Kushtetutës, duke mos parashikuar asnjë përjashtim/lehtësim nga tarifa gjyqësore për këto kategori personash, që do të mundësonte aksesin e tyre në gjykatë;

8.4 Udhëzimi nr. 991/3-2010 ka anashkaluar parimin e aftësisë paguese, të shprehur në mënyrë implicite në nenin 155 të Kushtetutës, dhe, për këtë arsye, është i papajtueshëm me këtë nen;



8.5 Është cenuar *parimi i ligjshmërisë*, për shkak se udhëzimi nr. 991/3-2010 nuk ka respektuar kushtet e përcaktuara në nenin 155 të Kushtetutës, në bashkëveprim me nenin 118 të saj;

8.6 Si ligji nr. 9975/2008, ashtu edhe udhëzimi nr. 991/3-2010, nuk janë të qartë në lidhje me përcaktimin e termit “tarifë minimale”. “Tarifa” është barasvlerësuar me “taksën mbi aktet” nëpërmjet një udhëzimi, duke krijuar konfuzion normash midis vetë udhëzimit dhe nenit 156 të KPC-së. *Paqartësia* e normës juridike, në këtë rast, është bërë shkak për një aplikim jo uniform të saj në gjykatat e zakonshme, në çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës.

9. **Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë**, ka parashtruar prapësimet si vijon:

9.1 Kërkuesi, QNLQ-ja, nuk legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës për interpretimin e nenit 155 të Kushtetutës, pasi nuk i plotëson kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, më konkretisht nga vendimi nr. 24, datë 9.6.2011, për të kërkuar interpretimin e këtij neni;

9.2 QNLQ-ja nuk legjitimohet në kërkimin për papajtueshmëri të ligjit dhe aktit normativ, objekt shqyrtimi, me Kushtetutën, për shkak se një kërkesë e tillë mund të bëhet vetëm për çështje që lidhen me interesat e saj. QNLQ-ja nuk e plotëson këtë kriter të parashikuar në nenin 134/2 të Kushtetutës, sepse normat e kundërshtuara nuk cenojnë interesat dhe qëllimin e veprimtarisë së saj që konsiston në dhënien e ndihmës ligjore për shtresat e varfra dhe, në mënyrë të veçantë, për gratë e dhunuara.

9.3 Gjykatat referuese nuk legjitimohen, sepse ligji i kundërshtuar nuk zbatohet në çështjen në shqyrtim dhe nuk ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë mes këtij ligji dhe zgjidhjes së çështjes konkrete;

9.4 Ligji, objekt shqyrtimi, i plotëson kriteret e vendosura nga neni 17 i Kushtetutës, pasi kufizimi i një të drejte, në kuadrin e procesit të rregullt ligjor, është bërë me ligj dhe në shërbim të interesit publik, në përputhje me politikat e shtetit për grumbullimin e të ardhurave të ligjshme;

9.5 Ligjvënësi ka respektuar nenin 118 të Kushtetutës në nxjerrjen e akteve nënligjore përkatëse, duke pasur parasysh se vetë ligji autorizon nxjerrjen e udhëzimit, përcakton organet kompetente, çështjen që rregullohet dhe parimet në bazë të të cilave është nxjerrë ky udhëzim;

9.6 Përcaktimi i “tarifave të shërbimit”, si një e drejtë e ligjvënësit, dhe ngarkimi i institucioneve përgjegjëse për nxjerrjen e akteve nënligjore, në zbatim të ligjit, nuk cenojnë nenin 42 të Kushtetutës;

9.7 Ligji që kundërshtohet nuk diskriminon asnjë grup të caktuar shtetasish kundrejt të tjerëve, por vetëm vendos “tarifa shërbimi” për sektorë të ndryshëm dhe përcaktimin e niveleve minimale të këtyre tarifave ia delegon akteve nënligjore.

10. **Subjektet e interesuara, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave**, kanë parashtruar prapësimet si vijon:

10.1 Gjykatat referuese nuk legjitimohen t’i drejtohen Gjykatës, pasi nuk kanë plotësuar kriteret që parashikon neni 145/2 i Kushtetutës për të iniciuar kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit. Nuk ka pasur çështje konkrete për gjykim, për arsye se mospagimi i taksës mbi aktet ka penguar fillimin e shqyrtimit gjyqësor të çështjeve civile të paraqitura në gjykatat referuese. Mungon edhe lidhja e drejtpërdrejtë midis dispozitës së kundërshtuar dhe zgjidhjes së çështjes konkrete.

10.2 QNLQ-ja nuk legjitimohet për shkak se norma e kundërshtuar nuk sjell pasoja të drejtpërdrejta apo të tërthorta mbi objektin apo qëllimin e veprimtarisë së saj. Kjo qendër nuk ka ushtruar ankimin administrativ dhe nuk i është drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, duke mos shteruar në këtë mënyrë mjetet ligjore të disponueshme;

10.3 Kërkimi i QNLQ-së për interpretimin përfundimtar të nenit 155 të Kushtetutës është i papranueshëm, sepse nuk plotëson kriteret kushtetuese të vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës;

10.4 Ometimi ligjor, në lidhje me përjashtimin e kategorive vulnerabël nga parapagimi i tarifës gjyqësore, nuk mund të bëhet objekt i kontrollit kushtetues;

10.5 Parapagimi i tarifës gjyqësore është i nevojshëm për të garantuar funksionimin e rregullt të veprimtarisë gjyqësore dhe i shërben interesit të përgjithshëm publik;

10.6 Ligji, objekt shqyrtimi, nuk cenon të drejtën e aksesit në gjykatë, bazuar dhe në statistikat zyrtare të cilat pasqyrojnë respektimin e kësaj të drejte. Vendosja e tarifës së shërbimit ka për qëllim pikërisht garantimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi për kryerjen e shërbimeve gjykata kryen shpenzime për funksionimin dhe administrimin e saj. Që prej vitit 2002 kur u vendos kjo taksë, emërtimi i të cilës ndryshoi në “tarifë” me ligjin nr. 9975/2008, nuk është parashikuar ndonjë përjashtim për kategori të caktuara dhe as nuk është parashtruar ndonjëherë çështja e kushtetutshmërisë përpara Gjykatës.

10.7 Aktet nënligjore përkatëse kanë dalë në kuadër të rezervës ligjore relative për të përcaktuar tarifat minimale të shërbimit dhe në përputhje të plotë me kriteret që përcakton neni 118 i Kushtetutës;

10.8 Ligji konkret nuk cenon parimin e barazisë, të parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës, pasi nuk bën diferencim në taksimin e qytetarëve nëse shërbimi që kërkohet është i njëjtë.

II

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

11. Gjykata Kushtetuese, përpara se të analizojë themelin e kërkesës, vlerëson të nevojshme të ndalet fillimisht te pretendimet e përfaqësuesve të subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave, për sa i takon legjitimitit të kërkuarve përpara kësaj Gjykate.

A. Për legjitimitimin e kërkuarve

12. Subjektet e interesuara, Kuvendi i Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave, kanë ngritur pretendimin se kërkuarët nuk legjitimohen t’i drejtohen Gjykatës në lidhje me kërkimin për papajtueshmëri me Kushtetutën të akteve ligjore përkatëse, objekt shqyrtimi.

13. Çështjen e legjitimitit (*locus standi*) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Kërkesa për kontroll incidental, që përbën mjetin e aksesit të gjykatës së juridiksionit të zakonshëm në gjykimin kushtetues, rregullohet nga neni 145/2 i Kushtetutës sipas të cilit, kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën nuk i zbatojnë ato, por pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen kësaj Gjykate, për t’u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e tij.

14. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese është konkretizuar nga neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i cili përcakton disa kushte, të cilat duhet të respektohen nga gjykata referuese për të iniciuar gjykimin incidental: *së pari*, gjatë një procesi gjyqësor ajo duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); *së dyti*, duhet të parashtrorë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e ligjit ose dispozitave të tij duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës. Para marrjes së vendimit të pezullimit të çështjes, gjykata referuese duhet të konkludojë se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa i dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Në të kundërt, nëse gjykata referuese çmon se një ligj nuk do të zbatohet nga ana e saj për zgjidhjen e çështjes, edhe pse sipas saj vlerësohet si jokushtetues, ajo duhet të vazhdojë me gjykimin e çështjes (*shih vendimet nr. 6, datë 17.2.2012; nr. 30, datë 17.6.2010; nr. 2, datë 3.2.2010; nr. 13, datë 4.5.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, Gjykata çmon se gjykatat referuese i kanë plotësuar kërkesat si më sipër, duke identifikuar ligjin e zbatueshëm, lidhjen e drejtpërdrejtë midis dispozitave ligjore që kundërshtohen, dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes së themelit, si dhe duke parashtruar arsyet për jokushtetutshmërinë e ligjit, referuar në normat dhe parimet konkrete të Kushtetutës. Rrjedhimisht, ato legjitimohen⁴ t’i drejtohen Gjykatës në lidhje me kërkimin për kontroll incidental të dispozitës

⁴ Gjyqtarët V. Kristo dhe V. Tusha votuan kundër legjitimitit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.



ligjore, objekt shqyrtimi.

16. Për sa i përket legjitimitit të QNLQ-së, Gjykata nënvizon se, në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciues, që parashikohen në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. “Organizatata e tjera”, të specifikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, janë ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre (*shih vendimet nr. 5, datë 16.2.2012; nr. 11, datë 6.4.2010 dhe nr. 35, datë 10.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata është shprehur se vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premisat teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit. Vetëm fakti që dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë pasur një efekt çfarëdo mbi kërkuesin, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ai legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që janë qëllimi i veprimtarisë së kërkuesit, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (*shih vendimet nr. 43, datë 6.10.2011; nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 31, datë 18.6.2010; dhe nr. 16, datë 25.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata konstaton, bazuar edhe në ligjin nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, se “qendra” është person juridik pa anëtarësi, që ka për objekt të veprimtarisë së saj kryerjen e shërbimeve dhe realizimin e projekteve për qëllime në të mirë dhe në interes të publikut, me fonde dhe të ardhura të siguruar sipas ligjit (neni 11). QNLQ-ja është një organizatë jofitimprurëse, e regjistruar si person juridik me vendimin gjyqësor nr. 8, datë 6.11.2001. Qëllimi i kësaj organizate, sipas nenit 4 të Statutit, i ndryshuar me vendimin gjyqësor nr. 8/1, datë 14.12.2004, është “të ofrojë ndihmë ligjore, pa shpërbllim, për shtetas të varfër, në mënyrë të veçantë për gratë e varfra e të dhunuara, përfshi këtu dhe vënien në dispozicion të një avokati për ndjekjen e çështjeve gjyqësore, deri në shqyrtimin përfundimtar të tyre, pranë policisë, prokurorisë, pranë Gjykatës Kushtetuese, ose në gjykata ndërkombëtare, si dhe ndërmjetësimin për të realizuar të drejtat e këtyre shtetasve pranë organeve të administratës publike apo të pushtetit vendor”.

19. Duke e vlerësuar legjitimitimin e QNLQ-së në vështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata çmon se kjo qendër nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të këtij gjykimi abstrakt kushtetues, për arsye se nuk ka arritur të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin është krijuar apo veprimtarisë që ajo kryen dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat, të cilat kërkon të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën. Gjithashtu, në vlerësimin e Gjykatës, ajo nuk ka arritur të provojë një interes të drejtpërdrejtë, të sigurt dhe vetjak në çështjen konkrete. Referuar statusit të saj juridik, si një qendër së cilës i mungon anëtarësia, ajo nuk përfaqëson interesa të anëtarëve të saj, por, në cilësinë e organizatës jofitimprurëse, ndjek një qëllim në të mirë dhe interes të publikut duke ofruar, ndër të tjera, ndihmë ligjore falas (*pro bono*) për disa shtresa të caktuara të popullsisë, të cilat nuk kanë mundësi të përballojnë financiarisht shërbimet e një mbrojtësi ligjor apo shpenzimet gjyqësore.

20. Në këto kushte, për arsyet e mësipërme, Gjykata çmon se QNLQ-ja nuk legjitimohet⁵ t’i drejtohet Gjykatës, për të kërkuar kontrollin kushtetues të dispozitave ligjore, objekt shqyrtimi.

⁵ Gjyqtarët Xh. Zaganjori, F. Hoxha dhe A. Thanza votuan “pro” legjitimitit të QNLQ-së.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës

21. Gjykatat referuese pretendojnë se neni 11/2 i ligjit nr. 9975/2008, i ndryshuar, nuk është në pajtim me Kushtetutën, pasi e kushtëzon aksesin në gjykatë me parapagimin e plotë të tarifës për shërbime gjyqësore, dhe nuk parashikon përjashtime në rastet e pamundësisë financiare për kryerjen e kësaj pagese.

22. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se “Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. E drejta për t’iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e së drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Aksesin në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor. Aksesin në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera (*shih vendimet nr. 14, datë 26.3.2012; nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 14, datë 3.6.2009 dhe nr. 7 datë 11.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Edhe GJEDNJ-ja ka pohuar se neni 6 § 1 garanton të drejtën e individit për t’iu drejtuar gjykatës. Ajo ka konsideruar se sipas këtij neni, detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Gjykata ka rikujtuar edhe njëherë se ajo asnjëherë nuk e ka përjashtuar mundësinë që interesat e administrimit të drejtë të drejtësisë mund të justifikojnë një kufizim financiar në të drejtën e aksesit në gjykatë. Megjithatë, duke pasur parasysh vendin e rëndësishëm që zë e drejta e aksesit në një shoqëri demokratike, këto kufizime nuk duhet të kufizojnë aksesin në një mënyrë apo shkallë që dëmton thelbin e kësaj të drejte (*shih Kreuz kundër Polonisë, 19 qershor 2001, perifrashim*). Në disa çështje konkrete, në lidhje me pagesën paraprake të tarifave gjyqësore, GJEDNJ-ja ka marrë parasysh mundësinë financiare të aplikantit për të paguar tarifën dhe fazën e procesit gjyqësor në të cilin është vendosur ky kufizim, si faktorë materialë për të përcaktuar nëse aplikanti e ka gëzuar të drejtën e aksesit (*shih Kreuz kundër Polonisë, nr. 28249/95, § 58-67, ECHR 2001 VI; Weissman dhe të tjerët kundër Rumanisë, nr. 63.945 / 00, § 33-43, ECHR 2006 VII (ekstrakte), Adnan Özdemir kundër Turqisë; vendimi i datës 20 maj 2010*).

24. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se sipas nenit 11/2 të ligjit nr. 9975/2008, të ndryshuar, përcaktimi i niveleve minimale të tarifave të shërbimit, ku përfshihen *inter alia* edhe tarifat për veprime e shërbime të administratës gjyqësore, bëhet me anë të udhëzimit të përbashkët të Ministrisë të Financave dhe institucioneve përkatëse. Siç shihet qartë, nga përmbajtja normative e nenit, kjo është një dispozitë deleguese, e cila i jep Ministrisë të Financave dhe institucioneve përkatëse të drejtën të përcaktojnë me udhëzim nivelet minimale të tarifave të shërbimit, të përkufizuara në ligj. Në vlerësimin e Gjykatës, kjo normë nuk e pengon aksesin e individit në gjykatë, por vetëm delegon kompetencën për përcaktimin e niveleve minimale të tarifave të shërbimit te institucionet përkatëse të administratës publike.

25. Për të garantuar të drejtën e një individit për t’iu drejtuar gjykatës, zbatimi i nenit 11/2 të ligjit nr. 9975/2008, të ndryshuar, duhet parë në raport me rregullimet e tjera ligjore që disiplinon paraqitjen e padisë. Më konkretisht, Gjykata e sheh të arsyeshme të ndalet te dispozitat përkatëse të KPC-së që trajtojnë këtë aspekt të procesit gjyqësor. Sipas dispozitave procedurale civile, gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë (neni 1). Për ngritjen e padisë dhe në momentin e paraqitjes së saj paguhet taksa mbi aktet, në rastet dhe në masën e caktuar sipas ligjit (nenet 102; 156). Taksa mbi aktet paguhet në bazë të vlerës së padisë (neni



104). Shpenzimet gjyqësore parapaguhën nga pala kërkuese por gjykata, duke marrë parasysh rrethanat e çështjes dhe gjendjen pasurore të palëve, mund të ngarkojë njërin ose të dyja palët që të paguajnë shpenzimet e tyre, pavarësisht se kush prej tyre ka kërkuar pyetjen e dëshmitarëve, kryerjen e ekspertimit ose të këqyrjes (neni 105). Gjyqtari vendos për përjashtimin e paditësit nga pagimi i taksës mbi aktet, në rastet e përcaktuara nga ligji (neni 158/a). Personat që, sipas dispozitave për taksën mbi aktet, përjashtohen nga pagimi i taksës, përjashtohen edhe nga pagimi i shpenzimeve të tjera gjyqësore (neni 105/b). Taksa mbi aktet dhe shpenzimet e tjera gjyqësore, nga pagimi i të cilave pala është përjashtuar sipas nenit 105/b, i ngarkohen palës tjetër në masën e pjesës së padisë që është pranuar nga gjykata (neni 106).

26. Çdo individ që i drejtohet me padi gjykatës, është i detyruar të parapaguajë taksën mbi aktet (ose “tarifën për shërbime gjyqësore”, sipas udhëzimit nr. 13/2009, *supra*), e cila caktohet mbi bazën e vlerës së padisë. Megjithatë, Gjykata vlerëson se, në vështrim të neneve të sipërcituara të KPC-së, gjyqtari i zakonshëm nuk pengohet të hetojë dhe të përjashtojë paditësin nga pagesa e kësaj tarife, në rastet kur ndodhet përpara pamundësisë financiare të tij për të bërë këtë pagesë. Gjyqtari i zakonshëm ka hapësirë për të vlerësuar plotësimin e këtij kriteri procedural për ngritjen e padisë dhe për të bërë përjashtimet rast pas rasti, në mënyrë që të mos pengojë realizimin e së drejtës së aksesit në gjykatë. Sipas dispozitave procedurale civile, në rastet e përjashtimit të individit nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore, ku përfshihet edhe taksa mbi aktet, këto shpenzime përballohen nga fondi përkatës i parashikuar në Buxhetin e Shtetit (neni 105/b). Nga ana tjetër, ligji nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, ka përcaktuar një organ shtetëror kolegjal, Komisionin Shtetëror për Ndihmën Juridike, detyra kryesore e të cilit është t’u ofrojë ndihmë juridike kategorive të caktuara të individëve, duke kryer shpenzimet përkatëse (nenet 10 dhe 14 të ligjit).

27. Nëpërmjet interpretimit sistematik të dispozitave të mësipërme të KPC-së, si dhe analogjisë me ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike” (përkatësisht nenet 2,10,13,14), arrihet qartësisht në përfundimin se qëllimi i këtij kuadri ligjor është të garantojë aksesin në gjykatë për të gjithë individët që i drejtohen gjykatës. Në funksion të këtij garantimi, si dhe të frymës që ligjvënësi ka dashur të përçojë në këtë kontekst ligjor, Gjykata thekson se i takon gjyqtarit të hetojë, mbi bazën e dokumentacionit provues të pamundësisë ekonomike të paraqitur nga paditësi, dhe të vlerësojë, duke iu referuar legjisllacionit procedural civil dhe rregullimeve ligjore përkatëse, nëse është rasti për përjashtimin e paditësit nga pagesa e tarifës për shërbime gjyqësore.

28. Për sa më sipër, Gjykata arrin në konkluzionin se, neni 11/2 i ligjit nr. 9975/2008, *i ndryshuar*, nuk cenon të drejtën e aksesit në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

C. Për pretendimin e cenimit të nenit 155 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 118 të saj

29. Gjykatat referuese kanë parashtruar se neni 11/2 i ligjit nr. 9975/2008, *i ndryshuar*, duke ia deleguar formalisht dhe substancialisht të drejtën e caktimit të tarifave Ministrave përkatës me udhëzim, bie ndesh me rezervën ligjore të parashikuar nga neni 155 i Kushtetutës që ia ka lejuar vetëm ligjit të drejtën për të vendosur taksa, tatime apo detyrime financiare kombëtare e vendore. Përveç kësaj, gjykatat referuese argumentojnë se neni 11/2 nuk plotëson detyrimet kushtetuese, të parashikuara në nenin 118 të Kushtetutës, për nxjerrjen e akteve nënligjore.

30. Neni 155 i Kushtetutës parashikon se “Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj...”. Ndërsa neni 118 i Kushtetutës sanksionon se “1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë. 2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte”.

31. Gjykata çmon se rezerva ligjore që parashikon neni 155 i Kushtetutës për sa i përket, *inter alia*, caktimit të taksave, tatimeve dhe detyrimeve financiare kombëtare e vendore, është një rezervë ligjore relative. Në rastin e *rezervës ligjore absolute* Gjykata ka theksuar se është norma kushtetuese ajo që ia rezervon vetëm ligjit rregullimin e një marrëdhënieje konkrete, ndërsa në rastin

e rezervës ligjore relative, çështja konkrete mund të rregullohet edhe nga aktet nënligjore (*shih vendimin nr. 19, datë 9.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Në vlerësimin e Gjykatës duhet dalluar koncepti i taksës, si një detyrim financiar që duhet paguar nga të gjithë individët, nga ai i tarifës së shërbimit, që në rastin konkret është një detyrim financiar i cili paguhet në këmbim të një shërbimi në fushën gjyqësore. Termi “ligj” i përdorur në Kushtetutë dhe në përgjithësi në legjislacion, ka raste që nënkupton një interpretim të gjerë duke përfshirë dhe aktet nënligjore. Kjo ka të bëjë me rastet që u përkasin rregullimeve të përgjithshme, që nënkuptojnë përdorimin e termit “ligj” në kuptim të legjislacionit ose të së drejtës dhe jo të aktit të organit ligjvënës. Për të përcaktuar nëse ndodhemi para njërit ose tjetrit variant, rëndësi ka të sqarohet konteksti, nga i cili del qëllimi i normës (*shih vendimin nr. 20, datë 11.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin e rezervës ligjore relative, aktet nënligjore duhet të nxirren në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 118 të Kushtetutës, të cilat nga njëra anë e detyrojnë ligjvënësin t’u përmbahet atyre në mënyrë rigorozë dhe nga ana tjetër orientojnë dhe kufizojnë pushtetin normativ të organeve të tjera shtetërore në nxjerrjen e akteve nënligjore.

32. Në rastin konkret, neni 11/2 i ligjit nr. 9975/2008, *i ndryshuar*, ia ka deleguar përcaktimin e niveleve minimale të tarifave të shërbimit, ku përfshihen dhe tarifatat për veprime e shërbime të administratës gjyqësore, Ministrinë të Financave dhe institucioneve përkatëse të cilët autorizohen të nxjerrin për këtë qëllim një udhëzim të përbashkët. Gjykata vlerëson se kjo dispozitë deleguese, ndryshe nga sa pretendojnë gjykatat referuese, respekton rezervën ligjore relative, të parashikuar në nenin 155, si dhe kriteret për nxjerrjen e akteve nënligjore, të sanksionuara në nenin 118. Kështu, neni objekt shqyrtimi, ka autorizuar nxjerrjen e akteve nënligjore, ka përcaktuar organin kompetent, si dhe çështjet specifike që duhen rregulluar mbi bazën e parimeve kryesore në fushën e taksave, tatimeve dhe detyrimeve financiare.

33. Për sa më sipër, Gjykata nuk gjen elemente të cenimit të standardeve, të përcaktuara në nenet 118 dhe 155 të Kushtetutës, nga përmbajtja normative e nenit 11/2 i ligjit nr. 9975/2008, *i ndryshuar*.

34. Si përfundim, në vijim të arsytimit të mësipërm, Gjykata vlerëson se neni 11/2 i ligjit nr. 9975/2008, *i ndryshuar* nuk cenon të drejtën e aksesit në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nuk bie ndesh me standardet e përcaktuara në nenet 118 dhe 155 të Kushtetutës. Për pasojë, kërkesa për shfuqizimin e tij është e pabazuar dhe duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 145/2 të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha

Anëtar kundër: Sokol Berberi



MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën, lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmoj të rëndësishme të dal me mendim pakice.

2. Nëpërmjet arsyetimit të saj, shumica ka arritur në konkluzionin se neni 11/2 i ligjit nr. 9975/2008, *i ndryshuar*, nuk cenon të drejtën e aksesit në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nuk bie ndesh me standardet e përcaktuara në nenet 118 dhe 155 të Kushtetutës. Nuk pajtohem me këtë vlerësim që ajo ka bërë, dhe në vijim do të parashtoj argumentet për qëndrimin tim të ndryshëm nga ai i shumicës.

A. Për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës

3. Përpara se të shprehem mbi themelin e pretendimeve, e çmoj të arsyeshme të sjell në vëmendje se tarifat për shërbime gjyqësore, sipas rregullimeve legjislative të viteve të fundit, kanë pësuar rritje në vazhdimësi dhe sidomos në mënyrë të konsiderueshme (rreth 8-fish) me aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit të ri për taksat kombëtare, nr. 9975/2008, objekt shqyrtimi. Për më tepër, në fund, është paraqitur në mënyrë të përmbledhur një tabelë me ndryshimet që ka pësuar kjo tarifë, duke filluar nga shfuqizimi i ligjit nr. 8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në RSH” (ligji nr. 8977/2002) e në vazhdim.

4. Për sa i përket pretendimit për cenim të së drejtës së aksesit në gjykatë, shumica ka çmuar se, në vështrim të dispozitave procedurale civile dhe rregullimeve ligjore përkatëse, gjyqtari i zakonshëm nuk pengohet të hetojë dhe të përjashtojë paditësin nga pagesa e tarifës, në rastet kur ndodhet përpara pamundësisë financiare të tij për të bërë këtë pagesë. Mbi bazën e këtij arsyetimi, ajo ka arritur në përfundimin se dispozita ligjore, objekt i kontrollit kushtetues, nuk cenon të drejtën e aksesit në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

5. Fillimisht, dua të nënvizoj faktin se bashkohem me parimet e theksuara nga shumica për sa i përket rëndësisë së të drejtës së aksesit në gjykatë dhe standardeve që duhen respektuar për të garantuar këtë të drejtë kushtetuese.

6. Duke iu kthyer çështjes konkrete dhe formulimit të nenit 11/2 të ligjit nr. 9975/2008, *të ndryshuar*, nivelet minimale të tarifave të shërbimit, ku përfshihen dhe tarifat për shërbime gjyqësore, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të titullarëve të institucioneve përkatëse. Ky nen në veçanti dhe vetë ligji në tërësi, nuk parashikojnë përjashtime nga pagesa e tarifës për shërbime gjyqësore për ndonjë kategori të caktuar individësh që gjendet në kushtet e pamundësisë financiare për ta paguar këtë lloj tarife. Në këtë linjë ka qenë edhe argumentimi i Kuvendit të Shqipërisë, i cili ka pohuar se ligji nuk diskriminon asnjë grup të caktuar shtetasish kundrejt të tjerëve (shih paragrafin 9.7 të vendimit) çka nënkupton se qëllimi i ligjvënësit ka qenë trajtimi i barabartë i të gjithë shtetasve për sa i përket pagimit të tarifës për shërbime gjyqësore. Shumica, qëndrimin e saj, e mbështet në vlerësimin e ligjit, objekt shqyrtimi, së bashku/në lidhje me parashikimet e KPC-së dhe ligjin për ndihmën juridike. Më poshtë, vlerësohet nëse këto rregullime ligjore e lejojnë gjykatën të përjashtojë nga pagesa e tarifës gjyqësore një individ për shkak të pamundësisë financiare.

7. Nga një vështrim sistematik i dispozitave procedurale civile, të cilat janë përmendur edhe nga shumica (shih paragrafin 25 të vendimit) vërehet se: a) tarifa për shërbime gjyqësore (taksa mbi aktet) parapaguhet në momentin e paraqitjes së padisë, në rastet dhe në masën e përcaktuar nga ligji (nenet 102, 105, 156 të KPC-së); b) nëse tarifa për shërbime gjyqësore nuk paguhet, gjyqtari i kthen aktet paditësit dhe padia mbetet pa veprime deri në momentin e plotësimit të këtij kushti (neni 154/a i KPC-së); c) gjyqtari vendos për përjashtimin e paditësit nga pagimi i taksës mbi aktet, në rastet e përcaktuara nga ligji (neni 158/a). Është e qartë nga ky kuadër ligjor se për ngritjen e padisë, në rastet e parashikuara nga ligji, parapagimi i tarifës për shërbime gjyqësore është kusht i detyrueshëm për vazhdimin e gjykimit. Në kuptim të nenit 158/a të KPC-së, përjashtimi i paditësit nga pagimi i

taksës mbi aktet, bëhet vetëm në rastet e përcaktuara nga ligji, i cili duhet të shërbejë si referencë për gjyqtarin. Ligji konkret, objekt shqyrtimi, nuk parashikon raste përjashtimi nga pagimi i tarifës për shërbime gjyqësore, duke penguar në këtë mënyrë aksesin në gjykatë për individët të cilët nuk kanë mundësi ta paguajnë këtë taksë. Po kështu, edhe ligji nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, të cilit i është referuar shumica, nuk ka përcaktuar mbulimin e tarifës gjyqësore në kuadrin e ndihmës juridike që shteti iu ofron kategorive të caktuara të individëve. Në bazë të neneve 10, 11, dhe 12 të këtij ligji, ndihma juridike jepet nga avokatët e specializuar në formën e ndihmës juridike parësore (dhënia e informacionit për sistemin ligjor dhe asistencë për hartimin e akteve juridike) dhe ndihmës juridike dytësore (dhënia e shërbimit të përfaqësimit e mbrojtjes me avokat). Padyshim, edhe shpenzimet përkatëse të cilat kryhen nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike, në funksion të ofrimit të ndihmës juridike, shkojnë për të mbuluar shërbimet e mbrojtësit, në përputhje me çka është parashikuar në ligj.

8. GJEDNJ-ja ka shqyrtuar në disa raste çështje të cilat kanë të bëjnë me efektet e kufizimeve financiare mbi të drejtën e aksesit në gjykatë, në këndvështrim të nenit 6 të KEDNJ-së (shih ndër të tjera *Tolstoi Miloslavsky kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 13 korrik 1995, § 61-67; *Kreuz kundër Polonisë*, 19 qershor 2001, § 58-67; *Weissman dhe të tjerët kundër Rumanisë*, 24 maj 2006, § 33-43, *Adnan Özdemir kundër Turqisë*, 20 maj 2010; § 21-22; *Apostol kundër Gjeorgjisë*, 28 nëntor 2006, § 58-65, etj). Ajo ka nënvizuar, ndër të tjera, se “e drejta e aksesit në gjykatë mund të jetë subjekt i kufizimeve në formën e rregullimit nga shteti i cili gëzon një hapësirë të caktuar vlerësimi. Nuk është detyrë e saj të zëvendësojë autoritetet kompetente shtetërore në përcaktimin e politikave më të përshtatshme për rregullimin e aksesit në gjykatë. Roli i saj është që të shqyrtojë, në bazë të Konventës, vendimet që këto autoritete [shtetërore] kanë marrë në ushtrimin e kompetencave të tyre të vlerësimit” (*shih Tolstoi-Miloslavsky kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 13 korrik 1995*). Në çështjen *Kreuz kundër Polonisë, datë 19 qershor 2001*, GJEDNJ-ja është shprehur se “vlera e tarifës, e vlerësuar në dritën e rrethanave të veçanta të një çështjeje të caktuar, duke përfshirë aftësinë e aplikantit për t’i paguar ato, dhe fazën e procesit në të cilën vendoset kufizimi, janë faktorë materialë në përcaktimin nëse një person e ka gëzuar ose jo të drejtën e tij të aksesit në gjykatë. (...) edhe pse shumica e [tarifës] që i është kërkuar përfundimisht aplikuesit është ulur ndjeshëm në krahasim me atë të caktuar më parë, ajo është gjithsesi e barabartë me pagën mesatare vjetore në Poloni në atë kohë. Duke vlerësuar faktet e rastit si një i tërë (...), Gjykata konsideron se autoritetet gjyqësore nuk kanë arritur të sigurojnë një ekuilibër të duhur ndërmjet, nga njëra anë, interesit të shtetit në mbledhjen e tarifave gjyqësore për shqyrtimin e kërkesëpadive dhe, nga ana tjetër, interesit të aplikantit për të mbrojtur pretendimet e tij në gjykatë”. Në të njëjtin konkluzion ka arritur GJEDNJ-ja edhe në çështjen *Weissman dhe të tjerë kundër Rumanisë, datë 24 maj 2006*, ku ka evidentuar se “shumica në fjalë për të paraqitur padinë ishte shumë e lartë dhe nuk ishte e justifikuar nga rrethanat e veçanta të rastit apo pozita financiare e aplikantit, por ishte llogaritur thjesht mbi një përqindje të caktuar të vlerës së objektit të padisë. Si rezultat, aplikantët u detyruan të hiqnin dorë nga ngritja e padisë, gjë e cila i ka privuar ata nga e drejta që rasti i tyre të degjohej nga një gjykatë”.

9. Duke iu referuar standardeve që burojnë nga jurisprudenca e mësipërme e GJEDNJ-së, shteti duhet të arrijë një ekuilibër të drejtë mes, nga njëra anë, interesit të tij në mbulimin e shpenzimeve të procesit gjyqësor dhe, në anën tjetër, interesit të individëve për të pasur akses në gjykatë, çka nuk mund të thuhet se është arritur në rastin konkret. Nuk i takon Gjykatës Kushtetuese të zëvendësojë autoritetet kompetente shtetërore në përcaktimin e masës së tarifës për shërbime gjyqësore por, në funksion të garantimit të së drejtës së aksesit në gjykatë, është detyrë e saj të shqyrtojë dhe të vlerësojë vendimet që këto autoritete shtetërore kanë marrë në ushtrimin e kompetencave të tyre të vlerësimit. Në këto kushte, çmoj se mosparashikimi i përjashtimeve, nga ligjvënësi, për kategori të veçanta individësh, të cilët gjenden në pamundësi financiare për ta paguar tarifën për shërbime gjyqësore, përbën një kufizim të së drejtës së aksesit në gjykatë, të tillë, që



dëmton vetë thelbin e kësaj të drejte. Për këto arsye, në ndryshim nga shumica, vlerësoj se Gjykata duhej ta pranonte kërkesën dhe të shfuqizonte, si të papajtueshëm me Kushtetutën, nenin 11/2 të ligjit nr. 9975/2008, të ndryshuar.

10. Për më tepër, dua të vë në dukje veçanërisht faktin se, interpretimi i shumicës, në lidhje me mundësinë e bërjes së përjashtimit nga ana e gjyqtarit, sipas rregullimeve ligjore përkatëse (dispozitave të KPC-së dhe ligjit nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”), lë shteg për arbitraritet. Kjo, për arsye se kuadri ligjor, të cilit i referohet shumica, nuk përcakton as rastet e përjashtimit, as shkallën apo fazën e procesit në të cilat shtrihet përjashtimi, dhe as kriteret mbi bazën e të cilave do të bëhet përjashtimi (afatet e paraqitjes së dokumentacionit, dokumentacioni që duhet të paraqitet, kufijtë minimale dhe maksimale të të ardhurave financiare të subjekteve përfituese të përjashtimit, periudha kohore që merret në konsideratë në lidhje me këto të ardhura, përbërja familjare për efekt të përcaktimit të të ardhurave, si bëhet verifikimi i gjendjes financiare nga gjyqtari në rastet kur është e pamundur paraqitja e dokumenteve, etj.). Në vlerësimin tim, mungesa e kriterëve specifike ligjore ku gjyqtari duhet të mbështetet për të bërë përjashtimin nga pagesa e tarifës për shërbime gjyqësore, mbart rrezikun e arbitraritetit gjatë zbatimit në praktikë.

B. Për cenimin e nenit 155 të Kushtetutës, të lidhur me nenin 118 të saj

11. Në lidhje me këtë pretendim shumica ka çmuar se neni 11/2 i ligjit nr. 9975/2008, i ndryshuar, si dispozitë deleguese, respekton rezervën ligjore relative të parashikuar në nenin 155, si dhe kriteret për nxjerrjen e akteve nënligjore të sanksionuara në nenin 118, ndaj Gjykata nuk gjen elemente të cenimit të standardeve, të përcaktuara në nenin 118 dhe 155 të Kushtetutës.

12. Nuk pajtohem me këtë qëndrim të shumicës, për arsyet që parashtrihen në vijim.

13. *Së pari*, dua të nënvizoj se, tatimet dhe taksat janë instrumente shumë të rëndësishme, për të realizuar në një shkallë të gjerë politikën ekonomike shtetërore, çka mund të përbëjë një burim tensioni midis pushtetit të legjislatorit për vendosjen e tatim-taksave dhe kufizimeve kushtetuese për ushtrimin e këtij pushteti. Ligjet tatimore, duke qenë kryesisht të një natyre financiare, janë në mënyrë të veçantë teknike në raport me ligjet e fushave të tjera të së drejtës. GJEDNJ-ja e ka përkufizuar termin “tatim-vënie”, në parim, si një ndërhyrje në të drejtën e garantuar nga paragrafi i parë i nenit 1 të protokollit nr. 1, përderisa e privon personin e interesuar nga një pronë, që do të thotë nga shuma e parave që duhet të paguhet (*shih çështjen Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 29 prill 2008 § 59*). Sipas kësaj linje arsyetimi, tatim-vënia është një koncept i cili përfshin jo vetëm vendosjen e taksave dhe tatimeve por edhe të çdo detyrimi financiar nga ana e shtetit, që sjell si pasojë privimin e individit nga shuma monetare e kërkuar për të plotësuar këtë detyrim. Përgjithësisht, në përputhje dhe me jurisprudencën e GJEDNJ-së, shtetet gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi në fushën e taksave (*shih çështjen Della Ciaja kundër Italisë, datë 22 qershor 1999*).

14. *Së dyti*, parashikimi kushtetues i rregullimit me ligj, ka një funksion garantues të interesit publik të përgjithshëm, për arsye se garanton që, në fusha të caktuara veçanërisht delikate, si në rastin e të drejtave themelore kushtetuese, vendimet të merren nga Kuvendi, si organi më përfaqësues i pushtetit sovran. Nëpërmjet një mekanizmi demokratik, siç është rezerva ligjore, garantohet parimi i ligjshmërisë, duke qenë se legjislacioni parlamentar konsiderohet si burimi më i përshtatshëm që respekton të drejtat individuale dhe kënaq të ashtuquajturën *ratio* garantuese të rezervës ligjore. Neni 155 i Kushtetutës parashikon rregullimin me ligj të disa aspekteve specifike në fushën e taksave, tatimeve dhe detyrimeve financiare kombëtare e vendore, ndaj do ta vlerësoj në lidhje me nenin 118 të Kushtetutës, ashtu siç ka bërë edhe shumica. Këto dy dispozita, në harmoni me njëra-tjetrën, përcaktojnë qartë disa kritere të cilat duhet të plotësojë çdo ligj që cakton detyrime të natyrës financiare dhe përmban dispozita deleguese për nxjerrjen e akteve nënligjore. Më konkretisht, këto lloj ligjesh duhet të caktojnë:

- a) taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore;
- b) lehtësimin ose përjashtimin prej tyre të kategorive të caktuara të paguesve;
- c) mënyrën e mbledhjes së tyre; si dhe të:

ç) autorizojnë nxjerrjen e akteve nënligjore;

d) të përcaktojnë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte nënligjore.

15. Duke iu referuar çështjes konkrete, çmuj se neni 11/2 i ligjit nr. 9975/2008, nuk i plotëson kriteret e mësipërme që burojnë nga dispozitat e neneve 155 dhe 118 të Kushtetutës. Kështu, ky nen nuk përcakton kriteret dhe parimet mbi bazën e të cilave do të nxirren aktet nënligjore për rregullimin e çështjeve që kanë të bëjnë me tarifën e shërbimit, ku bëjnë pjesë edhe tarifën për shërbime gjyqësore. Në këtë mënyrë, në kushtet e mospërcaktimit të këtyre kërkesave esenciale, kjo dispozitë deleguese, paraqitet si një dispozitë që lejon një hapësirë/diskrecionalitet të pakufizuar në nxjerrjen e akteve nënligjore nga ministrinë përkatëse. Kriteret e lartpërmendura janë kumulative dhe jo alternative, që do të thotë se një dispozitë ligjore, e cila cakton detyrime financiare dhe është njëkohësisht dispozitë deleguese, duhet t'i plotësojë të gjitha këto kriteret.

16. Për sa i përket nenit 155 të Kushtetutës, kjo normë kushtetuese përmban në vetvete parimin e ligjshmërisë në fushën e taksave, tatimeve dhe detyrimeve financiare, kur parashikon se këto lloj detyrimesh financiare caktohen me ligj. Rezerva ligjore relative nënkupton, në këtë rast, që ligji nuk e rregullon tërësisht të gjithë fushën përkatëse, e cila integrohet edhe me akte të tjera nënligjore që kryesisht zgjidhin aspekte teknike. Ligji duhet të rregullojë çështjet thelbësore, duke parashikuar elementet esenciale të çdo lloj detyrimi financiar, siç janë: a) qëllimi i detyrimit financiar dhe fusha e aplikimit; b) subjektet që duhet ta paguajnë; c) kuota/kuantifikimi i detyrimit; d) baza sipas së cilës vendoset detyrimi.

17. Në rastin konkret, neni 11/1, germa “ç” e ligjit nr. 9975/2008, sanksionon se “quhen tarifa shërbimi edhe tarifën për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë, noterisë dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”. Nga formulimi i kësaj dispozite evidentohen: fusha e aplikimit të tarifës në shqyrtim (tarifa për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë, noterisë dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme); subjektet që e paguajnë (të gjithë ata individë që i drejtohen për shërbime administratës gjyqësore, Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë, noterisë dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme). Më tej, sipas nenit 11/2, të po këtij ligji, nivelet minimale të tarifave për shërbime gjyqësore përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë të Financave dhe të titullarëve të institucioneve përkatëse. Nuk mund të pranohet se një parashikim i tillë, kaq i përgjithshëm, përmbush kriterin e “caktimit me ligj”, siç kërkon neni 155 i Kushtetutës. Përmbushja e këtij kriteri realizohet jo vetëm nëpërmjet përcaktimit me ligj të fushës së aplikimit të tarifës për shërbime gjyqësore dhe të subjekteve që duhet ta paguajnë atë, por edhe nëpërmjet përcaktimit të parimeve dhe kriterëve bazë, sipas të cilave do të plotësohet disiplina normative e tarifës për shërbime gjyqësore, nga institucionet shtetërore, si dhe do të bëhet kuantifikimi i saj në vlerë monetare. Norma e kundërshtuar nuk ka përcaktuar kriteret dhe fushëveprimin brenda të cilit mund të ushtrohen kompetencat rregulluese të autoriteteve shtetërore dhe as kriteret bazë për kuantifikimin e tarifës për shërbime gjyqësore (p.sh. kufirin minimal dhe maksimal për caktimin e kuotave, sipas nevojave financiare të entit të cilit do t'i paguhet detyrimi financiar). Parimi i ligjshmërisë substanciale nuk lejon papërcaktueshmërinë absolute të kompetencës që ligji ia delegon autoriteteve të tjera shtetërore, siç janë Ministri i Financave dhe titullarët e institucioneve përkatëse, në rastin konkret. Ligjvënësi duhej të parashikonte kriteret e përshtatshme dhe të mjaftueshme për të kufizuar diskrecionalitetin e autoriteteve shtetërore që kanë rregulluar me akte nënligjore ministrinë tarifën për shërbime gjyqësore, në mënyrë që të shmangej mundësia e ushtrimit arbitrar të kompetencave nga ana e tyre. Një gjë e tillë nuk është bërë nga ligjvënësi dhe, për pasojë, dispozita ligjore, objekt shqyrtimi, nuk i plotëson kriteret minimale udhërrëfyese që kërkon neni 155 i Kushtetutës.

18. Edhe Gjykata Kushtetuese italiane, në lidhje me nenin 23 të Kushtetutës italiane që parashikon se detyrimet financiare vendosen mbi bazën e ligjit, është shprehur se ky përcaktim përbën rezervë ligjore relative. Por, parimi që përshkon nenin 23 të Kushtetutës, sipas saj, kërkon jo



vetëm që kompetenca për të rregulluar një detyrim financiar të jetë e bazuar në ligj, por edhe që ligji, i cili jep një kompetencë të tillë, të përcaktojë kriteret e përshtatshme dhe të mjaftueshme për të kufizuar diskrecionalitetin e autoritetit shtetëror gjatë ushtrimit të kompetencës së dhënë (*shih vendimet nr. 4/1957; nr. 67/1973; nr. 447/1988; nr. 37/2004; nr. nr. 32/2009; nr. 115/2011 të Gjykatës Kushtetuese italiane*).

19. Gjithashtu, është po kaq e qartë se, në përputhje me nenin 155 të Kushtetutës, lehtësimi apo përjashtimi nga pagesa e tarifës për shërbime gjyqësore të kategorive të caktuara të paguesve duhet të bëhet me ligj, dhe në këtë kontekst, është më e përshtatshme të rregullohet nga ligji konkret për taksat, tatimet dhe detyrimet financiare.

20. Nga sa më sipër, vlerësoj se neni 11/2 i ligjit, objekt shqyrtimi, cenon të drejtën e aksesit në gjykatë dhe nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 155 dhe 118 të Kushtetutës, duke mos respektuar, në këtë mënyrë, parimin e rezervës ligjore të vendosur nga neni 155, në lidhje me nenin 118 të Kushtetutës.

Anëtar: Sokol Berberi

Tabela 1. *Ndryshimet që ka pësuar tarifa për shërbime gjyqësore*

Lidhja nr. 5 e ligjit nr. 8977/2002 të shfuqizuar	Shtojca 1 e udhëzimit nr. 13, datë 12.2.2009	Shtojca 1 e udhëzimit nr. 991/3-2010:
a) padi të rrjedhura nga marrëdhënie kontraktore: 1500 lekë	a) padi të rrjedhura nga marrëdhënie kontraktore: 3000 lekë	a) padi të rrjedhura nga marrëdhënie kontraktore: 12000 lekë
b) për shkaktim dëmi me vleftë deri 100 000 lekë: 1500 lekë	b) për shkaktim dëmi me vleftë deri 100 000 lekë: 3000 lekë	b) për shkaktim dëmi me vleftë deri 100 000 lekë: 12000 lekë
c) për shkaktim dëmi me vleftë mbi 100 000 lekë: 1% e padisë	c) për shkaktim dëmi me vleftë mbi 100 000 lekë: 3000 lekë	c) për shkaktim dëmi me vleftë mbi 100 000 lekë: 3% e padisë

Ndreqje gabimi

Në vendimin nr. 16, datë 27.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 28, që i përket kërkesës së kërkuarit Eliano Canko, me objekt: “Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 41, datë 9.7.2010 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe i vendimit nr. 1068, datë 21.12.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi)”, në paragrafin 26, rreshti i fundit, bëhet ndreqja:

ishte: “(shih vendimet nr. 7, datë 27.4.2005 dhe nr. 31, datë 5.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese)”.

bëhet: “(shih vendimet nr. 7, datë 27.4.2005 dhe nr. 31, datë 5.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese)”.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 4.3.2013
Doli nga shtypi më 4.3.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 58 lekë